

RAPORTI VJETOR 2025

Contents

SHKURTIME	TERMINOLOGJIA	4
I. KORNIZA LIGJORE		5
II. MESAZHI I KOMISIONERIT DHE VIZIONI		6
III. E DREJTA PËR INFORMIM		9
III.1 MONITORIMI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE		9
III.1.1 Miratimi i dy modeleve të reja të Programeve të Transparencës për autoritetet publike		10
III.1.2 Indeksi i Transparencës Proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë		11
III.1.3 Indeksi i Transparencës Proaktive të njëjësive të vetëqeverisjes vendore		13
III.2 TRAJTIMI I ANKESAVE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT		14
III.3 RAPORTIM I AUTORITETEVE PUBLIKE MBI ZBATIMIN E KËRKESAVE TË LIGJIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT		17
III.4 REGJISTRI ELEKTRONIK I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT NË PORTALIN PYETSHTETIN.AL		19
III.5 TË DHËNAT E HAPURA, RIPËRDORIMI I INFORMACIONIT PUBLIK DHE KONSULTIMI PUBLIK		19
III.5.1 Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit në fushën e të dhënave të hapura		19
III.5.2 Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit në fushën e konsultimit publik		21
IV. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE		22
IV.1 MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA		22
IV.2 BASHKËPUNIMI ME EUROJUST		22
IV.3 TRAJTIMI I ANKESAVE		23
IV.4 HETIMI ADMINISTRATIV		24
V.4.1 Hetime administrative në zbatim të Rezolutës së Kuvendit		24
IV.4.2 Hetime administrative për kategoritë vulnerabël		26
IV.4.3 Hetime administrative të zhvilluara pranë Autoriteteve Kompetente		27
IV.4.4 Hetime administrative mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna më herët		29
IV.5 VENDIMMARRJA		29
IV.6 TRANSFERIMI NDËRKOMBËTAR		29
IV.7 NJOFTIMI PËR CENIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE		30
IV.8 NËPUNËSI I MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE		30
V. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË KONTEKSTIN E BRENDSHËM		32
V.1 MARRËDHËNIET ME KUVENDIN E SHQIPËRISË		32
V.1.1 Zbatimi i Rezolutës		32
V.2 PËRPUTHSHMËRIA E AKTEVE RREGULLATORE ME LEGJISLACIONIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE		33
VI. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE		34
VI.1 PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN		34
VI.1.1 Dokumenti i Anëtarësimit: Qëndrimi i përbashkët i Bashkimit Evropian		34
VI.1.2 Udhërrëfyesit		34
VI.1.3 Progres Raporti i Komisionit Evropian		34

VI.1.4 Raportime periodike në kuadër të procesit të integrimit.....	35
VI.2 PJESËMARRJA NË FORUME DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE.....	35
VI.2.1 Roli i Presidencës dhe Sekretariatit të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit.....	35
VI.2.2 Berlin – Edicioni XVI i ICIC.....	37
VI.2.3 Këshilli i Evropës vlerëson zbatimin e Konventës 205 nga Shqipëria.....	37
VI.2.4 Zyra e Komisionerit, anëtare në Grupin e Specialistëve të Konventës 205.....	38
VI.2.5 Seminar mbi Rastet e Veçanta për të drejtën e informimit.....	38
VI.2.6 Tryeza Rajonale “Initiative 2020”.....	38
VI.2.7 Asambleja Globale e Privatësisë.....	38
VI.2.8 Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.....	39
VI.2.9 Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB).....	39
VI.2.10 Samiti Global i Privatësisë, Shoqata Ndërkombëtare e Profesionistëve të Privatësisë... ..	40
VI.2.11 Bordi Mbikëqyës për Mbrojtjen e të Dhënave të EUROCONTROL.....	41
VI.2.12 Akademia e Mbrojtjes së të Dhënave.....	41
VI.2.13 Pjesëmarrje në takimin e punës “European Case Handling Workshop 2025”.....	41
VII. NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE.....	42
VII.1 AKTIVITETET NDËRGJEGJËSUESE DHE DITËT NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE.....	42
VII.2 BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE.....	47
VIII. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE.....	48
VIII.1 AKTE RREGULLATORE.....	48
VIII.1.1 Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 124/2024.....	48
VIII.1.2 Udhëzimi nr. 463/2020.....	50
VIII.2 DOKUMENTE STRATEGJIKE.....	50
VIII.2.1 Strategjia Institucionale dhe Plani i Integritetit 2022-2025.....	50
VIII.2.3 Strategji Ndërsektoriale.....	50
VIII.3 PROCESE GJYQËSORE.....	52
VIII.3.1 Çështje me objekt zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”.....	52
VIII.3.2 Çështje me objekt zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.....	53
IX. MENAXHIMI BUXHETOR.....	55
IX.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE.....	55
IX.2 MENAXHIMI I BUXHETIT.....	56
IX.3 ARKËTIME NGA SANKSIONET.....	57
ANEKS 1 - STRUKTURA DHE ORGANIGRAMA.....	58
ANEKSI 2 - MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA REZOLUTA E KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2025.....	61
ANEKS 3 – REKOMANDIMET E ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR VITIN 2025 PËR INSTITUCIONET PUBLIKE DHE NIVELI I ZBATIMIT TË TYRE.....	62
ANEKSI 4 - TITULL.....	63

SHKURTIME

TERMINOLOGJIA

AP	Autoritete Publike
BE	Bashkimi Evropian (European Union)
Direktiva e Policisë	Direktiva (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 27 prillit 2016 “Për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale apo ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”
GDPR	Rregullore (BE) nr. 2016/679 “Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” (General Data Protection Regulation)
GPA	Asambleja Globale e Privatësisë – Global Privacy Assembly
ICIC	Konferenca Ndërkombëtare e Komisionerëve të Informimit (International Conference of Information Commissioner)
KiE	Këshilli i Evropës (Council of Europe)
Ligji nr. 119/2014	Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar
Ligji nr. 33/2022	Ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”
Ligji nr. 124/2024	Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”
Ligji nr. 49/2022	Ligji nr. 49/2022, datë 12.05.2022, “Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve, në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale (Konventa 108+)””
Ligji nr. 45/2022	Ligji nr. 45/2022, datë 28.04.2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumenta zyrtare (Konventa 205)””
NJVV	Njësi të Vetëqeverisjes Vendore
OSP	Organe të sektorit publik
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PT	Programi i Transparencës, tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik, sipas përcaktimeve të neneve 4 dhe 7 të ligjit për të drejtën e informimit
REKPI	Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit
Zyra e Komisionerit	Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

I. KORNIZA LIGJORE

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është person juridik publik dhe autoriteti i pavarur mbikëqyrës, përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit në fushat përkatëse që lidhen me të drejtën e informimit, ripërdorimin e informacionit të sektorit publik dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Veprimtaria e institucionit zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor të mëposhtëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 23 garanton të drejtën për informim dhe neni 35 garanton mbrojtjen e të dhënave personale;
- Ligji nr. 45/2022 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare””;
- Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9288/2004 “Për ratifikimin e Konventës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale””, i ndryshuar;
- Ligji nr. 49/2022 “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale””;
- Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- Ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.
- Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- Ligji nr. 113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”;
- Ligji nr. 38/2025 “Për përpunimin e informacionit të udhëtimit në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”;
- Ligji nr. 72/2019 “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

II. MESAZHI I KOMISIONERIT DHE VIZIONI

“Demokracia jeton nga transparencja dhe fuqizohet nga mbrojtja e të dhënave personale”

Në thelb të një shteti demokratik qëndron ekuilibri ndërmjet dy të drejtave themelore: aksesit në informacion dhe mbrojtjes së të dhënave personale. E drejta për informim fuqizon qytetarët, rrit përgjegjshmërinë e institucioneve dhe kontribuon në ndërtimin e besimit publik, ndërsa mbrojtja e të dhënave personale garanton respektimin e integritetit dhe dinjitetit të individit në një shoqëri gjithnjë e më të digjitalizuar.

Raporti vjetor për vitin 2025 paraqet veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në ushtrimin e mandatit të saj rregullator, mbikëqyrës, vendimmarrës, këshillues dhe advokues. Përmes këtij raporti pasqyrohet progresi i arritur në forcimin e standardeve të transparencës dhe në konsolidimin e mekanizmave për mbrojtjen e të dhënave personale, në një kontekst të karakterizuar nga zhvillimet e shpejta teknologjike dhe transformimi digjital i administratës dhe shoqërisë.

Gjatë vitit 2025 një rëndësi e veçantë i është kushtuar zhvillimit të mëtejshëm të kuadrit rregullator në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, në vijim të miratimit të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Një ndër prioritetet kryesore të institucionit ka qenë hartimi dhe miratimi në kohë i akteve nënligjore në

zbatim të këtij ligji, të cilat plotësojnë arkitekturën rregullatore dhe krijojnë instrumentet e nevojshme për zbatimin praktik të standardeve të reja në këtë fushë. Angazhimi i institucionit në këtë proces është vlerësuar pozitivisht edhe nga institucionet e Bashkimit Evropian, si një përmbushje në kohë dhe në përputhje me standardet evropiane të mbrojtjes së të dhënave.

Krahas zhvillimeve në planin rregullator, një vëmendje e veçantë i është kushtuar ndërgjegjësimit dhe edukimit mbi të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Gjatë vitit janë zhvilluar aktivitete informuese, fushata ndërgjegjësuese, tryeza diskutimi dhe programe trajnimi me institucionet publike, sektorin privat dhe organizatat e shoqërisë civile, me synimin për të forcuar kulturën e respektimit dhe zbatimit të këtyre të drejtave.

Gjithashtu, në planin ndërgjegjësues u organizua Konferenca Kombëtare për të Drejtën e Informimit, me temë “Agora e Transparencës” e cila shërbeu si një platformë dialogu ku u diskutuan sfidat e transparencës institucionale dhe u promovua bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile, medias dhe trupit diplomatik.

Një tjetër drejtim i rëndësishëm i veprimtarisë së institucionit ka qenë promovimi dhe përmirësimi i zbatimit të programeve të transparencës në autoritetet publike. Në këtë kuadër, programet model të transparencës janë zhvilluar dhe promovuar si instrumente që mbështesin institucionet në publikimin proaktiv të informacionit dhe në përmirësimin e komunikimit me publikun, duke lehtësuar aksesin e qytetarëve në informacionin me interes publik.

Ndërsa në planin ndërkombëtar, një moment historik për institucionin dhe për vendin tonë ka qenë vazhdimi i rolit të Shqipërisë si drejtuese e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC). Presidenca në këtë forum global përfaqëson një vlerësim domethënës për kontributin e institucionit të Komisionerit për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në promovimin e standardeve ndërkombëtare të transparencës dhe të drejtës për informim.

Zgjerimi i kuadrit ligjor dhe rritja e përgjegjësisë së institucionit, veçanërisht pas hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, nxjerr në pah nevojën për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve profesionale dhe financiare të Zyrës së Komisionerit. Zgjerimi dhe specializimi i burimeve njerëzore, si dhe investimi i vazhdueshëm në zhvillimin profesional të stafit dhe të nëpunësve të mbrojtjes së të dhënave dhe koordinatorëve për të drejtën e informimit, mbetet thelbësor për përmbushjen efektive të misionit të institucionit.

Në një epokë ku teknologjia dhe përdorimi masiv i të dhënave po transformojnë mënyrën se si funksionon shoqëria, sfida jonë mbetet të ruajmë ekuilibrin ndërmjet inovacionit, transparencës dhe mbrojtjes së të drejtave themelore. Vetëm përmes një vizioni të qartë dhe një bashkëpunimi të qëndrueshëm institucional mund të garantojmë që e drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale të vijojnë të jenë shtylla të forta të demokracisë dhe të shtetit të së drejtës.

Besnik Dervishi



STATISTIKA VJETORE

1751
ANKESA

157
INSPEKTIVE
NË TERREN

58
REKOMANDIME

50
VENDIME

79
SEANCA
DËGJIMORE

367
KOORDINATORË

474
DPO
272
REKPMI

DHËNIE MENDIMI

35
AKTE LIGJORE
NËNLIGJORE

76
OPINIONE

III. E DREJTA PËR INFORMIM


III.1 MONITORIMI I TRANSPARENCËS PROAKTIVE

Transparenca proaktive përbën një shtyllë thelbësore të mirëqeverisjes, duke forcuar kulturën e përgjeshmërisë dhe llogaridhënies, si dhe duke mundësuar pjesëmarrje sa më të gjerë të publikut në proceset vendimarrëse.

Gjatë vitit 2025, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Urdhrit nr. 211/2018 “Për miratimin e programit model të transparencës së njëjësive të vetëqeverisjes vendore” dhe Urdhrit nr. 187/2020 “Për miratimin e programit model të transparencës të rishikuar”, i ndryshuar, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar monitorimin e faqeve zyrtare të të gjitha autoriteteve publike. Në qendër të kësaj veprimtarie ka qenë vlerësimi i publikimit, rishikimit dhe përditësimit të Programeve të Transparencës sipas standardeve të miratuara, si edhe përmbushja e detyrimit ligjor për caktimin e koordinatorit për të drejtën e informimit nga autoritetet publike, në rastet e ndryshimeve apo përmirësimeve në strukturën e tyre organizative. Gjatë kësaj periudhe është konstatuar një rritje e lehtë e numrit të autoriteteve publike në raport me vitin e kaluar, për shkak të proceseve të ristrukturimit apo krijimit të institucioneve të reja me ligj ose akt nënligjor. Në total, Zyra e Komisionerit ka monitoruar transparencën proaktive të 367 autoriteteve publike, nga 355 që rezultuan në vitin 2024.

Nga monitorimi online rezultoi se 357 autoritete publike kanë të publikuar në faqet e tyre zyrtare Programin e Transparencës, ndërsa të gjitha autoritetet e monitoruarar kanë caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit. Të dhënat për koordinatorët janë publikuar dhe përditësuar edhe në portalin *pyetshtetin.al*.

Një tjetër detyrim ligjor për autoritetet publike dhe koordinatorët e tyre është mbajtja dhe publikimi i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve. Përmes monitorimit të vazhdueshëm online, Zyra e Komisionerit ka synuar që të sigurojë që informacioni dhe dokumentacioni të jetë i përditësuar, i plotë dhe lehtësisht i aksesueshëm për qytetarët, në përputhje me standardet e përcaktuara në Urdhrit nr. 188/2020 “Për miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar”. Për vitin 2025, rezulton se 348 autoritete publike kanë të publikuar online këtë Regjistër.



357 AP

kanë publikuar
Programin e Transparencës



367 AP

kanë caktuar koordinator për
të drejtën e informimit



348 AP

kanë përditësuar Regjistrin e
kërkesave dhe përgjigjeve

Në vijim të gjetjeve nga monitorimi online, Zyra e Komisionerit ka ndërmarrë dhe masa administrative shtesë, përfshirë hetime administrative, seanca dëgjimore, rekomandime dhe vendime, me qëllim garantimin e një qasje gjithëpërfshirëse dhe proaktive ndaj transparencës institucionale.

Gjatë vitit 2025, Zyra e Komisionerit i ka kushtuar vëmendje të posaçme sektorit shëndetësor, me synim forcimin e transparencës proaktive në spitalet publike universitare dhe rajonale. Këto institucione për shkak të funksionit, shtrirjes gjeografike dhe rolit në ofrimin e shërbimit për qytetarët, përbëjnë një hallkë themelore të sistemit shëndetësor publik. Nga ana tjetër, ky sektor ka një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve, ku qasja në informacion është jetike për shëndetin publik dhe rrjedhimisht, rritet nevoja për llogaridhënie dhe efikasitet institucional. Në këtë kuadër Zyra e Komisionerit, siguron që qytetarët të kenë akses të qartë, të shpejtë dhe të plotë në informacionin që lidhet me shërbimet shëndetësore, programet dhe vendimet institucionale. Me qëllim përmirësimit e mëtejshëm të këtij sektori, Komisioneri ka nxjerë 12 rekomandime për zbatimin e Programit të Transparencës nga ana e tyre.

Gjithashtu, janë zhvilluar hetime administrative në 51 autoritete publike, me objekt, zbatimin, publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës, emërimin e koordinatorit për të drejtën e informimit si dhe publikimin dhe përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve. Për të siguruar vendimmarrje të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, Zyra e Komisionerit zhvilloi 14 seanca dëgjimore përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Në përfundim të procedurave administrative, Komisioneri ka konstatuar raste të mospërbushjes së detyrimeve ligjore dhe ka vendosur 12 sanksione administrative me gjobë ndaj titullarëve të autoriteteve publike, për moszbatimin/mospërditësimin e Programeve të Transparencës. Gjithashtu, për autoritetet që nuk kishin përmbushur detyrimin ligjor për publikimin/përditësimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve, Zyra e Komisionerit ka vijuar procedurat administrative përmes shkresave zyrtare për marrjen e masave lidhur me të. Në vijim, për ato autoritete publike të cilat nuk morën masa për përmbushjen e detyrimeve ligjore u zhvilluan 6 seanca dëgjimore. Në përfundim të procedurës administrative, rezultoi se 1 koordinator për të drejtën e informimit nuk përmbushi detyrimet ligjore përkatëse, për çka është marrë 1 vendim sanksion administrativ, gjobë. 13 vendimet sanksionuese të Komisionerit kategorizohen si më poshtë:

- 6 vendime me sanksion administrativ për moszbatim të Programit të Transparencës ndaj titullarit të autoritetit publik;
- 6 vendime me sanksion administrativ për mospërditësim të Programit të Transparencës ndaj titullarit të autoritetit publik;
- 1 vendim me sanksion administrativ për mospërditësim të Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve ndaj koordinatorit për të drejtën e informimit.

Gjatë procesit monitorues dhe procedurave administrative, Zyra e Komisionerit ka konstatuar se sfidat kryesore të autoriteteve publike në zbatimin e transparencës proaktive lidhen kryesisht me mungesën e ndërgjegjësimit institucional, të burimeve njerzore të trajnuara dhe të stafit të dedikuar për përditësimin e informacionit në faqet zyrtare. Këto mangësi ndikojnë në vonesa, mungesë koherence apo publikime të paplota duke kufizuar aksesin e qytetarve në informacion publik. Këto gjetje theksojnë nevojën për forcimin e kapaciteteve njerzore, financiare dhe teknologjike të autoriteteve publike me qëllim rritjen e transparencës institucionale dhe efektivitetit të monitorimit nga Zyra e Komisionerit.

III.1.1 Miratimi i dy modeleve të reja të Programeve të Transparencës për autoritetet publike

Zyra e Komisionerit ka kryer një rishikim të kuadrit ekzistues që rregullon Programin e Transparencës, i cili përbën një instrument kyç të transparencës proaktive. Gjithashtu ai

garanton aksesin e publikut në informacion dhe dokumente me interes publik, redukton nevojën për paraqitjen e kërkesave individuale për informacion dhe forcon llogaridhënien institucionale.

Pas analizës së kuadrit aktual, u vlerësua se modelet ekzistuese të Programeve të Transparencës, nuk pasqyronin më plotësisht zhvillimet e fundit ligjore dhe institucionale, përfshirë ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”, ndryshimet e ligjit për të drejtën e informimit, praktikat e konsoliduara të zbatimit, si dhe kërkesat në kuadër të procesit të integritetit evropian.

Megjithëse modelet ekzistuese kanë dëshmuar efektivitet në strukturë dhe përdorshmëri, janë propozuar disa përditësime me qëllim konsolidimin e praktikave të mira dhe harmonizimin e tyre me zhvillimet aktuale kombëtare dhe evropiane. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit miratoi urdhrin nr. 280/2025 “Për miratimin e Modelit të Programit të Transparencës për Autoritetet Publike” dhe urdhrin nr. 281/2025 “Për miratimin e Modelit të Programit të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”. Ky i fundit, parashikon përfshirjen e një fushe të re të dedikuar për veprimtarinë e Këshillave Bashkiak si një nga organet më të rëndësishme të NJVV-ve, si dhe zbatimin e këtij modeli edhe nga këshillat e qarqeve, me qëllim forcimin e transparencës së procesit të vendimmarrjes në nivel vendor.

Ndërkohë, në Programin model të Transparencës për autoritetet publike pasqyrimi i vendimmarrjes institucionale konsiderohet si një nga mekanizmat kryesorë të monitorimit të veprimtarisë publike. Në këtë kuadër kërkohet që autoritetet të publikojnë informacion të zgjeruar mbi procesin e integritetit evropian, duke përfshirë:

- dokumentet strategjike për integrimin evropian;
- raportime mbi zbatimin e detyrimeve që lidhen me këtë proces;
- raporte monitorimi, auditimi dhe vlerësimi nga Komisioni Evropian;
- si dhe dokumente të tjera që pasqyrojnë ecurinë e procesit të integritetit evropian.

Miratimi i këtyre programeve model, konsolidon përvojën pozitive të zbatimit të transparencës proaktive, rrit përdorueshmërinë e informacionit publik dhe e shndërron transparencën në një instrument më efikas në shërbim të qytetarëve, shoqërisë civile, medias dhe institucioneve publike. Të gjitha autoritetet publike janë të detyruara të zbatojnë këto modele brenda afatit 31 mars 2026.

Modelet e Programeve të Transparencës janë publikuar në faqen zyrtare në lidhjen <https://idp.al/programi-model-i-transparences-per-autoritetet-publike/>.

III.1.2 Indeksi i Transparencës Proaktive të institucioneve qendrore dhe të varësisë

Zyra e Komisionerit ka kryer për të gjashtin vit rradhazi monitorimin e transparencës proaktive të autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë, atyre të pavaruara, të sistemit të drejtësisë, të arsimit të lartë, të urdhrave profesionalë dhe shoqëritë tregtare ku shteti zotëron shumicën e aksioneve. Në këtë monitorim janë përfshirë 284 autoritete publike. Ky monitorim dhe hartimi i “Indeksit të transparencës proaktive të autoriteteve publike për vitin 2025”, është kryer duke marrë në konsideratë standardet e përcaktuara në urdhrin nr.187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar”, i ndryshuar. Indeksi 2025 i autoriteteve publike, përfshin monitorimin e 16 indikatorëve si më poshtë:

Treguesi I	Publikimi i Programit të Transparencës të AP	Treguesi IX	Kordinatori për të drejtën e informimit
Treguesi II	Struktura/Organigrama e AP	Treguesi X	Raporte monitorimi/auditimi
Treguesi III	Struktura e pagave të AP	Treguesi XI	Buxheti 2025
Treguesi IV	Funksionet dhe detyrat e AP	Treguesi XII	Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik 2025
Treguesi V	Procedura që ndjekin funksionarët e lartë të AP për të marrë vendime/Vendimmarrja	Treguesi XIII	Regjistri i realizimeve të prokurimit publik 2025
Treguesi VI	CV e titullarit të AP	Treguesi XIV	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025
Treguesi VII	Legjislacioni kombëtar	Treguesi XV	Lista e shërbimeve që ofron AP
Treguesi VIII	Rregullore e brendshme/për funksionimin e AP	Treguesi XVI	Lista e dokumenteve që administrohen nga AP me afatet e ruajtjes

Në përfundim të monitorimit rezulton kjo fotografi e transparencës proaktive, për institucionet qendrore dhe të varësisë:



Ngjyrë e gjelbër, me nivel transparence *të lartë* 149 autoritete publike ose 52.5% e totalit.

Ngjyrë e bardhë, me nivel transparence *mesatare* 102 autoritete publike ose 35.5% e totalit.

Ngjyrë e verdhë, me nivel transparence *të ulët* 32 autoritete publike ose 11.5% e totalit.

Ngjyrë e kuqe, me nivel transparence *minimale* 1 autoritet publik ose 0.5% e totalit.

Nga krahasimi i statistikave me shifrat e indekseve për vitin 2024, konstatohet se ka një përmirësim të transparencës proaktive të autoriteteve publike e cila reflektohet dhe tek numri i atyre të kategorizuara me transparencë proaktive të lartë nga 112 në 149. Në kategorinë e autoriteteve publike të listuara me transparencë proaktive mesatare, konstatohet një rënie e lehtë e numrit nga 111 në 102. Për grupin e atyre që janë kategorizuar me transparencë proaktive të ulët, shifrat flasin për një rritje të numrit nga 26 në 32, ndërsa, në kategorinë e fundit me transparencë proaktive minimale, shifrat flasin për një zbritje me 1 autoritet publik. Rritja nga një vit më parë me 13% e numrit të autoriteteve publike të monitoruara, si dhe rritja me 33% e treguesve, në thelb paraqesin një panoramë më të mirë përse i përket transparencës proaktive.

III.1.3 Indeksi i Transparencës Proaktive të njërive të vetëqeverisjes vendore

Monitorimi dhe hartimi i “Indeksit të transparencës proaktive të njërive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2025”, është kryer duke marrë në konsideratë standardet e përcaktuara në Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e programit të transparencës të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore”, të cilit i janë nënshtruar 61 bashki dhe Urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 “Për miratimin e programit të transparencës të rishikuar”, i ndryshuar, të cilit i janë nënshtruar 12 këshillat e qarqeve. Indeksi NJVV nga pikëpamja strukturore është i njëjtë me atë të viteve të kaluara, por më i zgjeruar për arsye se janë shtuar 4 tregues, duke e çuar numrin e tyre në 16.

Treguesi I	Publikimi i Programit të Transparencës	Treguesi IX	Koordinatori për të drejtën e informimit
Treguesi II	Struktura e pagave	Treguesi X	Raporte monitorimi/auditimi KLSH
Treguesi III	Funksionet e NJVV	Treguesi XI	PBA 2025- 2027/Buxheti 2025
Treguesi IV	Publikimi i vendimeve të NJVV	Treguesi XII	Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit/Raporti 8-mujor 2025
Treguesi V	CV e titullarit	Treguesi XIII	Regjistri i parashikimit të prokurimit publik 2025
Treguesi VI	CV e titullarit të AP	Treguesi XIV	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2025
Treguesi VII	Legjislacion kombëtar	Treguesi XV	Lista e shërbimeve që ofron NJVV
Treguesi VIII	Rregullore e brendshme për funksionimin dhe organizmin e NJVV	Treguesi XVI	Publikimi i informacionit mbi “Të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik”

Në përfundim të monitorimit rezulton kjo fotografi e transparencës proaktive, për njësitë e vetëqeverisjes vendore:



28 NJVV kanë “*transparencë proaktive të lartë*” (semafor i gjelbër) ose 38%.

33 NJVV kanë “*transparencë proaktive mesatare*” (semafor i bardhë) ose 45%.

8 NJVV kanë “*transparencë proaktive të ulët*” (semafor i verdhë) ose 11%.

4 NJVV kanë “*transparencë proaktive minimale*” (semafor i kuq) ose 6%.

Nga krahasimi i të dhënave me indeksin e vitit 2024, për këtë kategori institucionesh, konstatohet se ka një rënie të lehtë të autoriteteve publike të kategorizuara me transparencë


proaktive të lartë, nga 30 në 28. Nga ana tjetër, vihet re se ka një rritje të kategorisë së atyre të listuara me transparencë proaktive mesatare nga 30 në 33, ndërkohë që për grupin e institucioneve që janë kategorizuar me transparencë proaktive të ulët, kemi një zbritje të numrit nga 13 në 8 NJVV. Ndërsa, në kategorinë e fundit, me transparencë proaktive minimale, shifrat flasin për një rritje nga 0 në 4 NJVV.

Rezultatet e këtyre indekseve pasqyrojnë një përmirësim të transparencës proaktive, kryesisht nga ana e autoriteteve publike qendrore, të varësisë dhe sistemit të drejtësisë. Përsa i përket njësive të vetëqeverisjes vendore kemi një rënie të lehtë në transparencën proaktive. Në këtë kuadër, mbetet e nevojshme rritja e angazhimit institucional dhe forcimi i përgjegjshmërisë profesionale për adresimin e sfidave dhe problematikave të evidentuara.


III.2 TRAJTIMI I ANKESAVE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Gjatë vitit 2025 u administruan gjithsej 897 ankesa, nga të cilat 861 ankesa të reja dhe 36 të mbartura nga viti 2024. Krahasuar me vitet e mëparshme, vërehet një rënie e lehtë e numrit të ankesave, që mund të lidhet me përmirësimin gradual të transparencës proaktive të autoriteteve publike.

Nga këto ankesa, rreth 385 u depozituan ndaj institucioneve qendrore dhe atyre të varësisë, 293 ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore dhe 183 ndaj autoriteteve të tjera publike, ku pjesa më e madhe lidhet me institucionet qendrore.



Referuar të dhënave të administruara, ankesat janë grupuar në tre kategori kryesore sipas grafikut përkatës.



Nga 897 ankesa të trajtuara, për 525 raste, informacioni/dokumentacioni i kërkuar u është vënë në dispozicion ankuesve gjatë procesit të shqyrtimit administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit. Ndërkohë, institucioni është shprehur me 33 vendime për 34 ankesa. Nga këto, janë dhënë 20 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 11 vendime rrëzimi dhe 2 vendime me sanksion administrativ, gjobë.




Gjatë këtij viti, është vërejtur një interes i qëndrueshëm i publikut apo grupeve të interesit për akses në informacion publik, veçanërisht në çështjet që lidhen me funksionimin e autoriteteve publike, përdorimin e fondeve publike, si dhe tema me ndikim të drejtpërdrejtë social, ekonomik dhe mjedisor. Fushat kryesore të ankesave kanë qenë të fokusuar kryesisht në mungesën e dhënies së informacionit në lidhje me:

- Buxhetin e autoriteteve publike, veçanërisht në ndarjen dhe përdorimin e fondeve për aktivitete, projekte të ndryshme, prioritetet buxhetore, si dhe mënyrën e shpenzimit të tyre.
- Lejet e ndërtimit dhe planifikimit urban, VNM përkatëse si dhe dokumentacionet shoqëruese të tyre.
- Sektorin e shëndetësisë, kryesisht në buxhetin e akorduar për këtë sektor, me theks të veçantë të shërbimet onkologjike, spitalet e shëndetit mendor, furnizimi dhe prokurimi i medikamenteve.
- Procesin e rindërtimit, informacion mbi fondet, afatet dhe ecurinë e projekteve të rindërtimit pas tërmetit të vitit 2019.
- Akses në deklaratat e pasurive të zyrtarëve të lartë të administratës publike si dhe të sistemit të drejtësisë, me argumentin e forcimit të transparencës dhe luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit.
- Lehtësirat tatimore dhe përjashtimet nga TVSH-ja të përfituara nga shoqëritë tregtare.
- Menaxhimin e zonave bregdetare duke përfshirë përdorimin e hapësirave publike, në raport me vendimmarrjet e marra nga pushteti qendror, sidomos gjatë sezonit veror.
- Sektorin mjedisor, menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, politikat mjedisore dhe ndikimin në shëndetin e qytetarëve.
- Informacion lidhur me “Paketën e maleve”, si një instrument ligjor dhe zhvillimor me ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë lokale.
- Investimet publike dhe projektet infrastrukturore, si “Rruga e Arbrit”, autostrada Tiranë – Durrës, etj. Vazhdon interesi lidhur me koncesionet, partneritetet publike-private, si dhe studimet e fizibilitetit.
- Sigurinë ushqimore, interesi ka qenë i përqendruar në standardet e kontrollit, inspektimet dhe masat e marra për garantimin e sigurisë ushqimore.
- Çështjet të lidhura me të miturit dhe fenomenet sociale, kryesisht për bllokimin e rrjeteve sociale si TikTok, fondet për masat alternative ndaj dënimit të të miturve, shërbimin e proves, përdorimin e substancave narkotike nga kjo kategori, përdorimin e armëve etj.

Nga numri total i ankesave, 201 kanë rezultuar jashtë objektit të ligjit. Këto ankesa lidhen kryesisht me çështje me natyrë individuale ose me aspekte të rregulluara nga ligje të tjera specifike. Pavarësisht se këto ankesa nuk përfshihen në objektin e veprimtarisë së Komisionerit, institucioni është përpjekur t'i adresojë pranë autoriteteve përkatëse duke ndërgjegjësuar, rekomanduar dhe nxitur këto institucione që ti trajtojnë me objektivitet dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë kategori përfshihen dhe pyetjet apo kërkesat për pronocim publik kryesisht nga gazetarë, për të cilat Zyra e Komisionerit ka theksuar shpesh herë që duhet të ketë një rregullim të posaçëm ligjor.

Po ashtu, rezultojnë 25 ankesa të refuzuara bazuar në kufizimet e ligjit, 72 ankesa të paraqitura jashtë afatit, 16 të paplota, si dhe 24 të tjera të mbartura për shqyrtim në vitin 2026. Si pjesë e procesit të shqyrtimit administrativ për ankesat e depozituara, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar 13 inspektime pranë autoriteteve publike dhe 9 seanca dëgjimore.



Disa nga problematikat e konstatuara nga Zyra e Komisionerit gjatë shqyrtimit të ankesave janë:

- Ristrukturimi i autoriteteve publike. Organizimi i ri i tyre sjell vonesa në trajtimin e kërkesave për informacion për shkak të mos transferimit në kohë të detyrave apo fushave të përgjegjësive.
- Kërkesat voluminoze dhe komplekse. Një numër i konsiderueshëm ankesash (mbi 223) kanë përfshirë kërkesa me më shumë se gjashtë pika dhe me hark kohor shumëvjeçarë. Trajtimi i tyre kërkon angazhim shtesë për identifikimin dhe përgatitjen e dokumentacionit. Zyra e Komisionerit ka vlerësuar objektivisht vështirësitë administrative, por nuk ka përjashtuar autoritetet publike nga detyrimi ligjor për transparencë.
- Ndryshim i shpeshtë i koordinatorëve dhe vështirësitë e aksesit të tyre në strukturat e tjera të autoritetit publik. Për shkak të rolit dhe përgjegjësisë që koordinatori ka në trajtimin e kërkesave për informacion, Zyra e Komisionerit vijon të udhëzojë autoritetet të marrin masa për forcimin e pozitës së tyre në institucion.

- Paqartësi në trajtimin e çështjeve të së drejtës së autorit. Vijnë të evidentohen paqartësi nga ana e autoriteteve publike në lidhje me të drejtën e autorit të subjekteve të cilët marrin pjesë në procedura administrative.
- Kufizime të pajustificuara në kontratat publike. Përfshirja e klauzolave të konfidencialitetit që kufizojnë aksesin në informacionin dhe/ose dokumentacionin që lidhet me to.
- Keqpërdorim i dispozitave të ligjit nga kërkuesit për çështje me karakter individual si, aksesin në të dhënat personale, aplikime për leje ndërtimi, pronësi, apo procedura rekrutimit, etj.
- Kërkesa për dokumentacion të njësuar me origjinalin për përdorim në procese gjyqësore, një praktikë që tejkalon objektin e ligjit dhe bie ndesh me Kodin e Procedurave Administrative dhe Civile si dhe me ligjin “Për avokatinë”.
- Kërkesa në formën e pyetjeve ose prononcimesh për media, drejtuar autoriteteve publike apo titullarëve të cilat tejkalojnë qëllimin e ligjit.

III.3 RAPORTIM I AUTORITETEVE PUBLIKE MBI ZBATIMIN E KËRKESAVE TË LIGJIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Autoritetet publike sipas ligjit, janë të detyruara të bashkëpunojnë me Komisionerin, duke i siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tij. Ato raportojnë çdo vit, jo më vonë se data 31 janar e vitit pasardhës, lidhur me zbatimin e kërkesave të ligjit nr.119/2014, sipas formatit të miratuar nga Komisioneri. Në këtë kuadër, Komisioneri miratoi Urdhrin nr. 01, datë 05.01.2026 “Për miratimin e formatit të raportimit të autoriteteve publike mbi zbatimin e kërkesave të ligjit për të drejtën e informimit për vitin 2025”. Për herë të parë këtë vit, autoriteteve publike u është kërkuar të raportojnë edhe mbi numrin e kërkesave për informacion, 36% e numrit total të kërkesave, kanë marrë përgjigje brenda 3 ditëve pune. Kjo nënkupton të nxisë ndërgjegjësimin e autoriteteve publike në përsheptimin e kthimit të përgjigjeve para afatit ligjor prej 10 ditëve pune. Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorit të dërguar në 367 autoritete publike, tregojnë se 355 prej tyre kanë sjellë përgjigje pranë Zyrës së Komisionerit. Në tabelën e mëposhtme paraqitet krahasimi i të dhënave për këtë vit nga vetëdeklarimi i autoriteteve publike me vitin 2024.

	2025	2024
Nr. i autoriteteve që kanë raportuar	355	351
Nr. total i kërkesave për informacion publik	13029	11549
Kërkesa nga gazetarë	2979	3129
Kërkesa nga përfaqësues të shoqërisë civile	1051	1540
Kërkesa të deleguara tek një autoritet tjetër	669	611
Kërkesa që kanë marrë përgjigje të plotë	11017	9289

Kërkesa të refuzuara	248	191
Kërkesa që kanë marrë përgjigje të pjesshme/të kufizuar	390	688
Sa nga këto kërkesa kanë marrë përgjigje brenda 3 ditë pune	4666	--


Krahasuar me vitin 2024, evidentohet një rritje e kërkesave të trajtuara dhe e përgjigjeve të plota nga autoritetet publike. Analiza krahasimore tregon përmirësim të transparencës proaktive, i reflektuar edhe në uljen e numrit të kërkesave nga shoqëria civile dhe gazetarët. Tabela e mëposhtme paraqet gjendjen lidhur me kufizimin e përgjigjeve sipas nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit.

RASTET E KUFIZIMIT	2025	2024
Të drejtën për një jetë private	79	43
Sekretin tregtar	15	20
Të drejtën e autorit	5	7
Patentat	0	1
Sigurinë kombëtare	22	27
Parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale	84	88
Mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor	27	3
Formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit	0	3
Barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor	27	9
Këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike	2	22
Mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare	4	6
Të tjera	41	162

Krahasimisht me 2024 evidentohet kufizimi i përgjigjeve nga autoritete publike për arsye objektive të parashikuar në ligj duke reduktuar ndjeshëm arsyet e tjera të kufizimit.

III.4 REGJISTRI ELEKTRONIK I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT NË PORTALIN PYETSHTETIN.AL

Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit mundëson ushtrimin e së drejtës për informim përmes paraqitjes së kërkesave dhe, kur është e nevojshme, të ankesave pranë Zyrës së Komisionerit. Ky sistem siguron përfshirjen e drejtpërdrejtë të koordinatorit dhe garanton gjurmueshmërinë e procesit, duke minimizuar mundësinë për abuzim dhe/ose shmangie të detyrimeve ligjore.



Gjatë vitit 2025, Regjistri u instalua në 25 autoritete të reja, duke e çuar në 272 numrin total të autoriteteve të përfshira. Gjithashtu, janë zhvilluar trajnime të rregullta me koordinatorët për përdorimin e sistemit. Përmes këtij regjistri elektronik janë paraqitur nga qytetarët dhe grupet e interesit 426 kërkesa për informacion dhe 28 ankesa pranë Zyrës së Komisionerit

III.5 TË DHËNAT E HAPURA, RIPËRDORIMI I INFORMACIONIT PUBLIK DHE KONSULTIMI PUBLIK

Në epokën digjitale, të dhënat përbëjnë një nga burimet më të rëndësishme strategjike për zhvillimin ekonomik, qeverisjen demokratike dhe forcimin e besimit ndërmjet institucioneve publike dhe qytetarëve. Hapja e të dhënave dhe konsultimi publik nuk janë vetëm një detyrim formal, por procese që synojnë fuqizimin e qytetarëve, medias, shoqërisë civile dhe sektorin privat.

III.5.1 Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit në fushën e të dhënave të hapura

III.5.1.1 Aktet nënligjore në zbatim të ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

Me qëllim plotësimin e kuadrit rregullator në përputhje *acquis communautaire*, Zyra e Komisionerit ka luajtur një rol aktiv në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore. Në këtë kuadër, është miratuar Udhëzimi i Përbashkët nr. 2, datë 06.02.2025, i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministrit të Ekonomisë,

Kulturës dhe Inovacionit “Për licencën standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik”. Ky udhëzim krijon një kornizë të unifikuar për përdorimin e të dhënave të hapura të prodhuara nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike, duke siguruar që ato të përdoren lirisht nga kushdo dhe për çdo qëllim, me kushtin e vetëm që burimi i të dhënave të citohet saktësisht sipas licencës. Ky ligji, përcakton gjithashtu kategoritë e të dhënave me vlerë të madhe, ripërdorimi i të cilave sjell përfitime për shoqërinë dhe ekonominë. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre kategorive, parashikohen gjithashtu edhe karakteristikat që duhet të plotësojnë grupet specifike të të dhënave me vlerë të madhe, përfshirë formatin, aksesin dhe kushtet e publikimit. Në këtë kuadër, u koordinua puna me organet publike përgjegjëse për secilën kategori me qëllim hartimin e akteve nënligjore. Në vijim të këtij procesi, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ka miratuar Udhëzimin “Për përcaktimin e grupeve specifike të të dhënave me vlerë të madhe në fushat “gjeohapësinore” dhe “mjedisore dhe vëzhgimit të tokës”, si institucioni përgjegjës për këtë kategori të dhënash me vlerë të madhe.

III.5.1.2 Forcimi i kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit dhe organeve të sektorit publik.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale të stafit dhe përfaqësuesve të organeve të sektorit e sipërmarrjeve publike për zbatimin në praktikë të ligjit, Zyra e Komisionerit ka bashkëpunuar me projektin “Bashkimi Evropian për Qeverisjen e Mirë”. Si rezultat i këtij projekti u hartua dhe publikua “Komentari mbi kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit sektorin publik”. Ky akt përbën një udhëzues interpretues dhe praktik që ndihmon organet e administratës publike dhe sipërmarrjet shtetërore të kuptojnë në mënyrë të saktë konceptet e reja të ligjit, si dhe detyrimet që rrjedhin prej tij. Gjithashtu ai synon të orientojë aktorë të tjerë si bizneset, shoqëria civile, gazetarët dhe qytetarët, në ripërdorimin e informacionit publik në mënyrë të drejtë dhe efektive.

Në vijim të këtij bashkëpunimi u zhvilluan disa aktivitete informuese dhe sensibilizuese për forcimin e njohurive teknike të stafit dhe institucioneve publike. U organizua “Trajnimi për Trajnerët”, ku stafi i Zyrës së Komisionerit përfitoi njohuri të avancuara mbi konceptin e të dhënave të hapura, procesin e mbikëqyrjes dhe monitorimit, në përputhje me praktikën më të mira të vendeve anëtare të BE-së, si dhe u mbajt takimi ndërgjegjësues me organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike.

Gjithashtu, autoriteti ka përfituar asistencë teknike nga TAIEX në fushën e të dhënave të hapura përmes trajnimeve me ekspertë të huaj, të cilat u fokusuan te rritja e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit dhe të organeve të sektorit publik për zbatimin praktik të ligjit nr.33/2022.

III.5.1.3 Ofrimi i mbështetjes praktike për autoritetet publike në fushën e të dhënave të hapura

Zyra e Komisionerit përmes komunikimit me organet e sektorit publik, ka nxitur publikimin e listës së dokumenteve ekzistuese që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura si dhe ka qartësuar detyrimet ligjore për të promovuar të drejtën për ripërdorimin e dokumenteve publike. Në vijim të këtij procesi u është përcjellë komentari mbi kuptimin dhe zbatimin e ligjit nr.33/2022 si dhe pyetësori mbi ecurinë e zbatimit të tij. Pas përpunimit të përgjigjeve, rezultoi se nga 312 organe të sektorit publik dhe sipërmarrje shtetërore, 240 i janë përgjigjur, 187 kanë krijuar në faqen e tyre zyrtare rubrikën “Open Data/Të dhëna të hapura” ku kanë publikuar listën e dokumenteve të hapura, dhe 194 kanë caktuar personin e kontaktit.



240 OSP
kanë kthyer përgjigje



187 OSP
kanë krijuar rubrikën
Open Data/publikuar listën



194 OSP
kanë caktuar person kontakti

Pyetësi nxori në pah edhe disa problematika:

- paqartësi në kuptimin dhe zbatimin e konceptit të të dhënave të hapura në dallim me Programin e Transparencës;
- mungesë qartësie në përdorimin e licencave standarde;
- publikimin e dokumenteve në formate që nuk plotësojnë standardet e të dhënave të hapura;
- mungesë informacioni për portalin opendata.gov.al;
- forcim të kapaciteteve njerëzore dhe teknike.

Referuar problematikave të konstatuara, Zyra e Komisionerit do të përqëndrojë punën në ofrimin e asistencës teknike dhe ligjore për zbatimin e detyrimeve të ligjit si dhe monitorimin e organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve shtetërore për publikimin e informacionit në format të hapur dhe të ripërdorshëm në faqet zyrtare. Këto masa synojnë forcimin e zbatimit praktik të ligjit, akses më të gjerë për publikun dhe median në funksion të një administrate më të hapur dhe llogaridhënëse.

III.5.2 Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit në fushën e konsultimit publik

Konsultimi publik përbën një mekanizëm thelbësor të pjesëmarrjes së qytetare, që mundëson përfshirjen e komunitetit akademik, ekspertëve dhe medias në procesin e politikëbërjes, duke siguruar që vendimmarrja publike të jetë cilësore dhe e orientuar drejt nevojave të shoqërisë. Në këtë fushë, Zyra e Komisionerit, ushtron një rol rekomandues dhe në rast se konstaton shkelje të dispozitave ligjore, i propozon organit publik marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil. Gjatë vitit 2025, janë shqyrtuar dy ankesa ku në njërin rast, Zyra e Komisionerit ka propozuar marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës për mosrespektim të detyrimeve ligjore gjatë procesit të konsultimit publik, ndërsa në rastin tjetër ankesa është vlerësuar jashtë fushës së zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik.

IV. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

IV.1 MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA

Në kushtet e digjitalizimit të shërbimeve, zgjerimi i përdorimit të teknologjive të reja dhe rritjes së proceseve të përpunimit të të dhënave në sektorin publik dhe privat, respektimi rigoroz i standardeve ligjore dhe parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale merr rëndësi të veçantë.

Veprimtaria e Zyra e Komisionerit synon trajtimin e shkeljeve dhe parandalimin e tyre përmes monitorimit të vazhdueshëm, hetimeve administrative, dhënies së rekomandimeve, dhe promovimit të praktikave të mira. Hyrja në fuqi e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale ka sjellë sfida tranzitore për kontrolluesit, të cilët kërkojnë përshtatje të praktikave, investime në sigurinë e informacionit dhe forcim të rolit të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar autoriteteve kompetente për sigurinë publike ose kombëtare dhe për parandalimin e ndjekjen e veprave penale, me synim promovimin e përputhshmërisë së përpunimit të të dhënave personale me legjislacionin e ri në fuqi dhe respektimin e të drejtave dhe themelore.

Mungesa e politikave të qarta, procedurave të standardizuara dhe burimeve të mjaftueshme njerëzore e financiare pengojnë zbatimin efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit duke vështirësuar identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve për konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit si dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore. Rritja e numrit dhe kompleksitetit të ankesave nga subjektet e të dhënave, pasqyrojnë ndërjegjësim më të lartë qytetar, por nevojitet trajtim efektiv dhe në kohë. Përpunimi i të dhënave në mjedisin online, si dhe publikimi i tyre në media dhe rrjete sociale kërkojnë interpretim të kujdesshëm dhe proporcional të dispozitave ligjore, si dhe mbikëqyrje të vazhdueshme.

Më poshtë paraqitet veprimtaria e Zyrës së Komisionerit rreth procesit mbikëqyrës, adresimi i sfidave me qëllim përmirësimin e nivelit të mbrojtjes së të dhënave personale.

IV.2 BASHKËPUNIMI ME EUROJUST

Në zbatim të nenit 19 të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it, Zyra e Komisionerit, në cilësinë e autoritetit kombëtar mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave personale, ushtron kompetencat e saj ligjore për zhvillimin e shkëmbimeve të rregullta dhe të strukturuar të pikëpamjeve me institucionin e Eurojust. Përmes pikës së kontaktit në Eurojust, autoriteti realizon vlerësime periodike mbi përputhshmërinë e praktikave kombëtare me dispozitat e Marrëveshjes dhe me standardet e Bashkimit Evropian që rregullojnë mbrojtjen e të dhënave personale të cilat synojnë sigurimin e një niveli të lartë konformiteti me *acquis communautaire*.

Në përmbushje të këtij detyrimi, Zyra e Komisionerit dhe Oficeri për Mbrojtjen e të Dhënave të Eurojust-it, përgatisin dhe shkëmbejnë raporte vjetore mbi zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes, me fokus masat organizative dhe teknike për ruajtjen e sigurisë së informacionit dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit zhvilloi procesin monitorues pranë Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorive të Shkallës së

Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm (Tiranë, Fier, Shkodër, Gjirokastrë) dhe Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Qëllimi i monitorimit ishte vlerësimi i mënyrës së përpunimit të të dhënave personale, identifikimi i nivelit të zbatimit të detyrimeve ligjore dhe propozimi i masave për përmirësim në përputhje me Marrëveshjen me Eurojust. Në përfundim të këtij procesi, u hartua raporti i monitorimit “*Mbi marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust, në lidhje me zbatimin e detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale*”, në të cilin u evidentuan gjetjet dhe rekomandimet për secilën prej prokurorive.


Gjatë procesit të verifikimit, janë analizuar masat teknike dhe organizative për sigurimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave personale si dhe aspektet që lidhen me ligjshmërinë e mbledhjes, ruajtjes, transmetimit dhe asgjësimit të të dhënave në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe kufizimit në kohë të ruajtjes. Është evidentuar nevoja për përditësimin e kuadrit të brendshëm rregullator, veçanërisht në lidhje me shkëmbimin e informacionit me Eurojust, duke përcaktuar qartë kanalet e komunikimit, procedurat e transmetimit të të dhënave dhe rolin e Prokurorit Ndërlidhës, në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes. Gjithashtu, është vënë në dukje rëndësia e hartimit të politikave për menaxhimin e shkeljeve të të dhënave me procedura të qarta për raportim, vlerësim dhe parandalim, si dhe miratimin e politikave të sigurisë për sistemet e informacionit të përdorura gjatë veprimtarisë.

Një tjetër aspekt lidhet me forcimin e masave shtesë rregullatore, teknike dhe organizative për sigurinë e përpunimit, përfshirë kontrollin e aksesit në sistemet elektronike dhe dosjet fizike, dokumentimin e proceseve përpunuese dhe përdorimin e regjistrave të posaçëm për shkëmbimin e informacionit me Eurojust. Një qasje që vlen të veçohet nga ky proces, është respektimi efektiv i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, duke garantuar informacion të qartë, të aksesueshëm dhe transparent, si dhe respektimin e parimit të proporcionalitetit në rastet e kufizimeve për arsye hetimore apo sigurie nga ana e prokurorive. Në përfundim është rekomanduar zhvillimi i trajnimeve të vazhdueshme për Nëpunësit e Mbrojtjes së të Dhënave dhe për punonjësit që përpunojnë të dhëna personale.

IV.3 TRAJTIMI I ANKESAVE

Zyra e Komisionerit ka trajtuar gjithsej 854 ankesa të paraqitura nga qytetarë dhe subjekte të të dhënave, të cilat kanë pasur si objekt ushtrimin dhe respektimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, ndër të cilat veçohen:

- *e drejta për akses, informim, korigjim dhe fshirje të të dhënave personale;*
- *përhapja dhe vënia në dispozicion e të dhënave personale, pa pëlqimin e subjektit të të dhënave;*
- *përpunimi i të dhënave personale në kundërshtim me parimet e ligjshmërisë;*
- *publikimi i të dhënave personale në media dhe portale online;*
- *vendosja dhe përdorimi i sistemeve të monitorimit me kamera në ambiente publike dhe private, pa respektimin e kritereve ligjore;*
- *marketingu i drejtpërdrejtë dhe komunikimet e pakërkua, kryesisht përmes telefonatave;*
- *tejkalimi i afateve ligjore për ruajtjen e të dhënave personale, përtej qëllimit për të cilin ato janë mbledhur dhe përpunuar*



Viti 2025 ka shënuar dyfishim të numrit të ankesave krahasuar me një vit më parë. Kjo prirje dëshmon një njohje më të mirë të instrumenteve ligjore dhe angazhim më aktiv të qytetarve në ushtrimin e të drejtave të tyre. Në këtë kuptim, dinamika e ankesave përbën një tregues të rëndësishëm të zhvillimit të kulturës së mbrojtjes së të dhënave personale dhe të forcimit të rolit të individëve në mbrojtjen e tyre administrative.

IV.4 HETIMI ADMINISTRATIV

Gjatë këtij viti Zyra e Komisionerit ka zhvilluar gjithsej 93 procedura hetimi administrativ. Nga këto, 18 hetime janë iniciuar mbi bazë ankese nga qytetarët, ndërsa 75 prej tyre janë ndërmarrë me iniciativë të Zyrës së Komisionerit në ushtrim të kompetencave të saj mbikëqyrëse. Sa i përket shpërndarjes sipas kategorisë së kontrolluesve, 29 procedura hetimi administrativ janë zhvilluar ndaj kontrolluesve publikë, ndërsa 64 ndaj atyre privatë.

Hetimet administrative janë kryer në sektorin shëndetësor (*si klinika dentare, laboratorë mjekësorë*), bankar, arsimor (*universitete private dhe shtetërore*), në sektorin e transportit, shërbimeve TIK dhe telekomunikacionit, në organizata jofitimprurëse, në autoritetet kompetente si dhe kontrollues të tjerë.



!!!DO TA BEJ ME DESIGN NE PHOTOSHOP!!!

V.4.1 Hetime administrative në zbatim të Rezolutës së Kuvendit

Në zbatim të Rezolutës së Kuvendit për vitin 2025, Zyra e Komisionerit është angazhuar në zhvillimin e hetimive administrative për kontrollues publikë dhe privat në disa drejtime kryesore si:

- Zbatimi i legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorët si arsimi, shëndetësia, sistemi bankar dhe sektorin e shërbimeve TIK;
- Zbatimin e masave tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale (Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit).

Zbatimi i detyrimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale

Në sektorin e arsimit të lartë, u zhvilluan 9 hetime administrative, 5 ndaj kontrolluesve publik dhe 4 ndaj atyre privat. Në përfundim, Zyra e Komisionerit ka dalë me 9 Rekomandime.

Në sektorin shëndetësor, u realizuan 15 hetime administrative ndaj kontrolluesve privat. Në përfundim të tyre, Komisioneri ka dalë me 13 Rekomandime dhe 2 Vendime administrative.

Në sektorin e transportit, u zhvilluan 4 hetime administrative ndaj kontrolluesve privat, për 3 prej tyre Komisioneri ka dalë me Rekomandim ndërsa 1 rast është ende në proces.

Në përfundim të procesit të verifikimit dhe hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit konstatoi mangësi sistemike në organizimin dhe zbatimin e detyrimeve ligjore nga ana e kontrolluesve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në nivelin e përputhshmërisë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto problematika theksojnë mungesën e një kulture të konsoliduar të llogaridhënies, të menaxhimit të riskut dhe të sigurisë së informacionit.

Në mënyrë të detajuar, u konstatuan këto gjetje:

- Mungesë transparence në informimin e subjekteve të të dhënave.
- Përdorimi formal dhe i përgjithshëm i formularëve “tip” të pëlqimit.
- Mungesë e rregulloreve të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Mungesë e marrëveshjeve midis kontrolluesit dhe përpunuesit për përpunimin e të dhënave me palë të treta.
- Përdorimi i adresave individuale elektronike për komunikime zyrtare në institucionet arsimore.
- Publikimi i pamjeve apo të dhënave në rrjete sociale pa bazë të qartë ligjore.
- Ruajtje e pasigurt dhe mungesë e përcaktimit të afateve kohore të ruajtjes së dosjeve mjekësore.
- Akses i pakontrolluar në sistemet elektronike të menaxhimit të pacientëve.
- Mungesë e masave teknike të avancuara të sigurisë si enkriptimi i të dhënave shëndetësore, në rast incidenti kibernetik apo humbjeje të pajisjeve.
- Dërgimi i rezultateve laboratorike apo imazheve dentare përmes kanaleve jo të sigurta komunikimi.
- Publikimi i fotografive dhe videove të pacientëve për qëllime promovuese.
- Instalimi dhe përdorimi i sistemeve video-survejimit në mjete transporti apo stacionet pritëse pa sinjalistikën e duhur dhe pa politika të miratuara për aksesin dhe ruajtjen e pamjeve.
- Mbajtja dhe përpunimi i listave të pasagjerëve apo të dhënave identifikuese pa politika të qarta ruajtjeje dhe pa masa specifike sigurie, veçanërisht në rastet e rezervimeve online;
- Mungesë e marrëveshjeve për përpunimin e të dhënave me ofrues të platformave elektronike të rezervimit në aplikacion mobile, ku nuk përcaktohen qartë rolet (kontrollues/përpunues), detyrimet për sigurinë e të dhënave, transferimet ndërkombëtare dhe mekanizmat e raportimit të incidenteve.

Hetime administrative me objekt tematik mbi zbatimin e masave tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale.

Një pjesë e hetimeve administrative është përqëndruar në vlerësimin e masave të Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit si mekanizëm thelbësor për përpunimin e sigurt të të dhënave.

Në sektorin e shërbimit të teknologjisë u zhvilluan 9 hetime administrative. Në përfundim, Komisioneri ka dalë me 6 Rekomandime, dhe për 3 hetime ka mbartur vendimmarrjen në vitin pasardhës.

Në sektorin bankar janë zhvilluar 4 hetime administrative të cilat përfunduan me Rekomandime.

Zyra e Komisionerit, evidentoi mangësi dhe problematika në zbatimin e masave teknike dhe organizative të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në cenimin e parimeve themelore të mbrojtjes së të dhënave. Në mënyrë më të detajuar, u konstatuan këto problematika:

- Nuk zbatohen mekanizma specifik teknike dhe organizativë për të mbrojtur të dhënat nga akseset e paautorizuara, humbja, ndryshimi apo shpërndarja e paligjshme.
- Nuk disponohen akte/dhe ose politika të brendshme që të rregullojnë në mënyrë të strukturuar proceset e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, transmetimit dhe sigurisë së të dhënave personale.
- Nuk ofrohen informacione të qarta, të plota dhe lehtësisht të aksesueshme për subjektet e të dhënave.
- Nuk evidentohet ekzistenca e një strategjie apo plani të dokumentuar për ngritjen dhe funksionimin e një sistemi të integruar të sigurisë së informacionit.
- Nuk zbatohen standarde të mjaftueshme për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave gjatë përpunimit të përditshëm.
- Nuk dokumentohet një politikë e qartë për kohëzgjatjen e ruajtjes së të dhënave personale.
- Nuk janë marrë masa për caktimin e Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Nuk i kushtohet rëndësi formimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve që kanë akses në të dhëna personale.
- Nuk parashikohen detyrime të qarta kontraktore në rastet e delegimit të proceseve përpunuese te palë të treta.

IV.4.2 Hetime administrative për kategoritë vulnerabël

Vëmendje e veçantë i është kushtuar hetimeve që përfshijnë kategori vulnerabël, veçanërisht të mitur dhe viktime ose viktime të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore. Për shkak të gjendjes së tyre të ndjeshme sociale, psikologjike dhe ligjore, këto kategori kërkojnë nivel të shtuar mbrojtjeje dhe masa të përforcuara sigurie dhe konfidencialiteti në çdo fazë të përpunimit të të dhënave personale. Në këtë kontekst Zyra e Komisionerit ka theksuar zbatimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor dhe përpunimin e drejtë, të sigurt dhe të kufizuar në qëllim.

Në këtë kuadër, janë kryer 7 hetime administrative pranë institucioneve dhe kontrolluesve privatë, kryesisht shoqata dhe organizata jofitimprurëse, me objekt zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe verifikimin e rekomandimeve. Nga analiza e gjetjeve të konstatuara, janë identifikuar disa problematika si:

- Mungesa e akteve të brendshme rregullatore, në të cilat të përcaktohet qartë kategoria e të dhënave që përpunohen, qëllimi i përpunimit, bazat ligjore, afatet e ruajtjes dhe masat konkrete teknike e organizative të sigurisë.
- Mungesa e procedurave të posaçme për përpunimin e të dhënave sensitive, veçanërisht atyre që lidhen me të miturit, viktimat e dhunës dhe viktimat e trafikimit, përfshirë mekanizmat e kontrollit të aksesit dhe gjurmueshmërisë së përpunimit.
- Paqartësi në marrëdhëniet kontrollues-përpunues dhe palët e treta, për shkak të mungesës ose papërshtatshmërisë së klauzolave kontraktuale që përcaktojnë rolet, përgjegjësitë dhe detyrimet në kuadër të përpunimit të të dhënave personale.
- Nevoja për rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimit të stafit, sidomos të punonjësve që kanë akses të drejtpërdrejtë në të dhëna sensitive, me qëllim garantimin e një kulture të qëndrueshme të mbrojtjes së të dhënave brenda organizatave.

Në përfundim të hetimeve administrative, Zyra e Komisionerit ka adresuar rekomandime për 5 prej kontrolluesve me qëllim përmirësimin e kuadrit të brendshëm rregullator, forcimin e masave të sigurisë dhe garantimin e përputhshmërisë së plotë me kërkesat e ligjit. Analiza e praktikave aktuale evidenton se, ndonëse ekziston kuadri ligjor dhe procedurat e miratuara, zbatimi i tyre në praktikë paraqet boshllëqe në aspektin e standardizimit, dokumentimit, gjurmueshmërisë së vendimmarrjes dhe vlerësimit të rrezikut në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale për këto kategori subjektsh. Gjatë hetimeve është konstatuar nevoja për përditësimin e politikave të ruajtjes dhe asgjësimit të të dhënave, si dhe përfshirjen sistematike të parimit të mbrojtjes së të dhënave në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar.

Konsolidimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm në subjekte publike ose private që trajtojnë kategori vulnerabël përbën një kusht të domosdoshëm për garantimin efektiv të të drejtës për mbrojtje të të dhënave personale. Ky proces duhet të shoqërohet me përgjegjshmëri të qartë, transparencë procedurale dhe masa konkrete parandaluese, me qëllim që mbrojtja e të dhënave të mos mbetet një standard deklarativ, por të funksionojë si një garanci reale dhe konkrete për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve. Për kategoritë vulnerabël, në veçanti të miturit dhe viktimat e trafikimit, çdo cenim i konfidencialitetit, integritetit apo përdorimit të ligjshëm të të dhënave personale mund të prodhojë pasoja të rënda, përfshirë ri-viktimizimin, diskriminimin apo ekspozimin ndaj rreziqeve të reja.

IV.4.3 Hetime administrative të zhvilluara pranë Autoriteteve Kompetente

Pjesa III e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, vendos një regjim të posaçëm juridik për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente për qëllime të sigurisë publike, sigurisë kombëtare, parandalimit, hetimit, zbulimit dhe ndjekjes penale të veprave penale, si dhe ekzekutimit të sanksioneve penale. Ky regjim synon të balancojë nevojën e shtetit për të garantuar rendin dhe sigurinë publike me detyrimin për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, në përputhje me standardet kushtetuese dhe instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër, ligji vendos një sistem

të qartë parimesh dhe garancish materiale dhe procedurale, duke sanksionuar se përpunimi i të dhënave personale nga autoritetet kompetente duhet të jetë

- i bazuar në ligj dhe i mbështetur në një kompetencë të shprehur;
- i kufizuar në qëllimin specifik për të cilin është autorizuar;
- proporcional dhe i domosdoshëm në raport me objektivin e ndjekur;
- i saktë dhe i përditësuar;
- i sigurt, nëpërmjet zbatimit të masave teknike dhe organizative të përshtatshme.

Parashikohen detyrime të posaçme për autoritetet kompetente, ndër të cilat përfshihen:

- dokumentimi i veprimtarive të përpunimit;
- garantimi i gjurmueshmërisë së aksesit dhe ndërhyrjeve në sistemet e informacionit;
- ndarja e kategorive të të dhënave sipas natyrës dhe nivelit të ndjeshmërisë
- diferencimi i qartë midis kategorive të subjekteve të të dhënave (persona të dyshuar, të dënuar, viktimë, dëshmitarë etj), me qëllim shmangien e përpunimit të panevojshëm ose stigmatizues.

Gjithashtu, ligji parashikon mekanizma monitorimi dhe kontrolli nga autoriteti mbikëqyrës, duke garantuar që edhe në fushën e sigurisë dhe ndjekjes penale të mos krijohen hapësira të pambuluara nga kontrolli institucional dhe standardet e përgjegjshmërisë.

Seksioni mbi përpunimin e të dhënave personale nga Autoritetet Kompetente, konsolidon një regjim të diferencuar, por jo përjashtues nga parimet themelore të mbrojtjes së të dhënave personale. Ai synon të sigurojë që ushtrimi i kompetencave të autoriteteve të sigurisë dhe ndjekjes penale të zhvillohet brenda kufijve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, duke ruajtur ekuilibrin ndërmjet interesit publik për siguri dhe mbrojtjes së dinjitetit dhe të drejtave themelore të individit.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar hetime administrative në sektorë të ndryshëm të sistemit të drejtësisë penale si dhe institucioneve mbështetëse veprimtaria e të cilave lidhet me atë të Autoriteteve Kompetente, përfshirë strukturat e shërbimit të provës, institucionet e ekspertizës mjeko-ligjore, si dhe institucione/organizata që ofrojnë shërbime dhe mbështetje për azilkërkuesit dhe të huajt. Qëllimi i tyre ka qenë verifikimi i përputhshmërisë së proceseve të përpunimit të të dhënave personale në raport me kërkesat ligjore dhe standardet e zbatueshme. Në analizë të gjetjeve të konstatuara nga hetimet administrative, janë identifikuar disa problematika, si më poshtë:

- Mungesë e kuadri të plotë të brendshëm rregullator në të cilat të përcaktohen qartë kategoritë e të dhënave personale që përpunohen, qëllimin dhe bazën ligjore të përpunimit, afatin e ruajtjes, si dhe masat konkrete teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së tyre.
- Mungesë procedurash të posaçme për të dhënat sensitive dhe mekanizmash për kontrollin e aksesit, kufizimin sipas roleve, si dhe gjurmueshmërisë së veprimeve të kryera duke rritur rrezikun e cenimit të të dhënave personale.
- Paqartësi në marrëdhëniet kontrollues-përpunues duke rritur mundësinë e keqinterpretimit të përgjegjësive, aksesit apo përhapjes së paautorizuar.

- Nevoja për rritje të ndërgjegjësimit dhe trajnimit të stafit, veçanërisht për ata që kanë akses të drejtpërdrejtë në të dhëna personale e sensitive.

Në përfundim të këtyre hetimeve administrative, Zyra e Komisionerit ka konkluduar me 9 rekomandime me synim përmirësimin e praktikave të përpunimit.

IV.4.4 Hetime administrative mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna më herët

Në kuadër të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit, u zhvilluan 9 hetime administrative, nga të cilat 7 në kontrollues privatë dhe 2 ndaj organizatave jofitimprurëse. Këto hetime kishin për qëllim vlerësimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore dhe zbatimin në kohë të masave të vendosura më herët. Në përfundim të procesit, për një pjesë të kontrolluesve u konstatua përmbushja e plotë e detyrimeve brenda afateve të përcaktuara, çka çoi në përfundimin e procedurave administrative pa nxjerrjen e një vendimi përfundimtar. Ndërkohë, për kontrolluesit e tjerë, procedurat administrative vijojnë, dhe aktet përfundimtare pritet të miratohen dhe të publikohen gjatë vitit pasardhës.

IV.5 VENDIMARRJA

Për qartësimin e plotë të rrethanave e fakteve të konstatuara gjatë proceseve administrative Zyra e Komisionerit ka zhvilluar 50 seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve të interesuara. Në shifra përmbledhëse, për vitin 2025 Komisioneri u shpreh me:

- 46 Rekomandime;
- 4 Vendime që korrespondojnë me 12 sanksione me gjobë;
- 1 Urdhër (për korrigjimin e të dhënave personale).

Vendimmarrjet e vitit 2025 me sanksion administrativ, gjobë, janë përlllogaritur mbi një instrument të ri “*Metodologjisë për përlllogaritjen e masës së sanksioneve*”, e cila synon vlerësimin e drejtë, transparent dhe korrekt të masës së sanksionit administrativ ndaj një kontrolluesi/përpunuesi shkelës të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.



4

VENDIME



46

REKOMANDIME



1

URDHËR

IV.6 TRANSFERIMI NDËRKOMBËTAR

Në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale drejt vendeve që nuk garantojnë një nivel të mjaftueshëm mbrojtje të të dhënave personale, Zyra e Komisionerit ka trajtuar 13 kërkesa të paraqitura nga kontrolluesit. Në këtë proces, autoriteti ka ushtruar një rol aktiv mbikëqyrës dhe këshillues, duke orientuar subjektet mbi detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor dhe theksuar rëndësinë e respektimit të parimeve themelore të përpunimit të të dhënave personale.

Pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit të paraqitur dhe vlerësimit të masave mbrojtëse të propozuara nga kontrolluesit, Zyra e Komisionerit ka dalë me 3 vendime për lejimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale, në sektorin bankar. Gjatë vitit raportues është evidentuar gjithashtu rritje e ndjeshme e kërkesave për mendim, veçanërisht mbi mekanizmat juridik të lejimit të transferimeve ndërkombëtare dhe procedurave të autorizimit nga Zyra e Komisionerit.

IV.7 NJOFTIMI PËR CENIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në funksion të rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë në përpunimin e të dhënave personale, ligji nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” parashikon detyrimin për njoftimin e cenimeve të të dhënave personale pranë Zyrës së Komisionerit. Ky mekanizëm synon parandalimin dhe minimizimin e pasojave të mundshme për subjektet e të dhënave. Në zbatim të këtij detyrimi, 4 kontrollues privatë kanë raportuar pranë Zyrës së Komisionerit për mundësi cenimi të të dhënave personale. Në vijim të procedurës, autoriteti ka kërkuar dhe shqyrtuar dokumentacionin përkatës lidhur me verifikimet dhe masat e ndërmarra. Nga analiza rezultoi se nuk ka pasur përhapje të të dhënave personale, megjithatë, Komisioneri ka kërkuar marrjen e masave shtesë teknike dhe organizative për forcimin e sigurisë së të dhënave.

IV.8 NËPUNËSI I MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Zyra e Komisionerit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë rolit të Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si funksion kyç në strukturën e kontrolluesve dhe përpunuesve, për të garantuar zbatimin korrekt të detyrimeve ligjore në çdo fazë të përpunimit. Për këtë qëllim është krijuar një rrjet bashkëpunimi ndërmjet Zyrës së Komisionerit dhe Nënpunësve të Mbrojtjes së të Dhënave të kontrolluesve publikë/privatë, duke mundësuar shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi përgjegjësitë ligjore.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 347, datë 19.06.2025, që parashikon krijimin e Regjistrimit Elektronik të Nënpunësve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, si platformë e centralizuar për administrimin e të dhënave të tyre dhe për komunikim të drejtpërdrejtë me Zyrën dhe për ndarjen e praktikave ndërmjet tyre.

Një komponent kyç i konsolidimit dhe promovimit të rolit të Nënpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë trajnimet e specializuara. Zyra e Komisionerit ka organizuar aktivitete periodike ndërgjegjësuere dhe trajnime praktike për përgatitjen e tyre. Në këtë kuadër, u zhvillua trajnimi dy-ditor “*Trajnimi i Trajnerëve*”, nga ekspertë të Autoritetit Italian për Mbrojtjen e të Dhënave, në bashkëpunim me Organizatën për Zhvillim të Qëndrueshëm Shqiptar dhe mbështetjen e programit SMART Balkans të financuar nga Qeveria e Norvegjisë. Ky program ka për qëllim ndërtimin e një rrjeti kombëtar trajnerësh të certifikuar, të cilët do të vazhdojnë të trajnojnë Nënpunësit e Mbrojtjes së të Dhënave në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e GDPR-së. Temat e trajtuara përfshinë rolin dhe përgjegjësitë e Nënpunësit, menaxhimi i rrezikut dhe auditimi i përpunimit të të dhënave, menaxhimi i shkeljeve të sigurisë, përgatitja e politikave të privatësisë, menaxhimi i kërkesave të qytetarëve, transferimin ndërkombëtar të të dhënave, etikën, transparencën dhe komunikimin institucional.



Në bashkëpunim me Institucionin e Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar i Biznesit” Zyra e Komisionerit hartoi modulën e dedikuar për formimin dhe kualifikimin e Nëpunësve të Mbrojtjes së të Dhënave që do të ushtrorjnë funksionin në institucione publike dhe në sektorin privat. Gjatë vitit 2025, mbi 100 Nëpunës u pajisën me certifikatë të vlefshme pas trajnimit, ndërsa 339 kontrollues të sektorit publik, si dhe 135 kontrollues të sektorit privat, konfirmuan caktimin e këtij personi përgjegjës. Këto subjekte përfshijnë institucione që operojnë në fusha të ndryshme si telekomunikacioni, bankat, sigurimet, shëndetësia, arsimit, turizmi dhe shërbimeve të ndryshme, etj. Regjistri i Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave vijon të përditësohet në mënyrë vazhdueshme, duke reflektuar ndryshimet organizative dhe duke shërbyer si një instrument thelbësor për monitorimin dhe zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

V. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË KONTEKSTIN E BRENDSHËM

Zyra e Komisionerit, si institucion i pavarur përgjegjës për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dy të drejtave themelore, të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale, ka ushtruar një bashkëpunim të strukturuar dhe të vazhdueshëm me Kuvendin e Shqipërisë dhe me institucionet e tjera të administratës publike. Ky bashkëpunim nuk ka karakter formal, por mbart një dimension thelbësor substancial, që synon forcimin e koordinimit institucional, harmonizimin e praktikave dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Përmes këtij ndërveprimi institucional, forcohet kultura e komunikimit administrativ, rritet përgjegjshmëria institucionale dhe garantohet një zbatim koherent dhe i qëndrueshëm i legjislacionit përkatës. Njëkohësisht, ky bashkëpunim përbën një element kyç për realizimin e objektivave strategjike të Zyrës së Komisionerit në të dy fushat kryesore të përgjegjësisë së saj, duke siguruar efektivitet, transparencë dhe mbrojtje të prekshme të të drejtave të qytetarëve.

V.1 MARRËDHËNIET ME KUVENDIN E SHQIPËRISË

V.1.1 Zbatimi i Rezolutës

Raportimi vjetor i Zyrës së Komisionerit para Kuvendit u konkretizua me miratimin e “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2024”, në datën 9 tetor 2025. Përmes këtij akti, organi ligjvënës vlerësoi pozitivisht rezultatet e arritura dhe realizimin e objektivave institucionale gjatë vitit raportues, si dhe përcaktoi rekomandimet për vitin 2025, në funksion të forcimit të mëtejshëm të rolit mbikëqyrës dhe rregullator të Zyrës së Komisionerit.

Në përmbajtje të Rezolutës rekomandimet e Kuvendit janë përqendruar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale duke theksuar domosdoshmërinë e veprimit në disa drejtime kryesore, si:


- mbyllja e boshllëqeve nënligjore në zbatim të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në mënyrë që legjislacioni i ri të shoqërohet me instrumente të qarta zbatimi;
- hartimi dhe zbatimi i planeve të trajnimit në fushën e Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit duke adresuar vështirësitë që ende hasin institucionet në implementimin e tyre;
- forcimi i bashkëpunimit me institucionet arsimore, shëndetësore, financiare dhe teknologjike për të standardizuar praktikat dhe për të rritur ndërgjegjësimin në menaxhimin e të dhënave;
- organizimi i fushatave edukative të specializuara për grupet më të ndjeshme të shoqërisë dhe për administratën publike me qëllim parandalimin e shkeljeve dhe promovimin e kulturës së privatësisë në çdo fazë të procesit administrativ.

Megjithëse miratimi i Rezolutës, u realizua në një fazë të vonuar të vitit, Zyra e Komisionerit ka përmbushur plotësisht rekomandimet e përcaktuara nga Kuvendi, përmes miratimit të akteve nënligjore përkatëse, realizimit të programeve të trajnimit, intensifikimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe organizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuere të dedikuara.

V.2 PËRPUTHSHMËRIA E AKTEVE RREGULLATORE ME LEGJISLACIONIN PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Gjatë vitit 2025, Zyra e Komisionerit ka ushtruar në mënyrë aktive rolin e saj këshillimor dhe monitorues përmes dhënies së 111 mendimeve dhe opinioneve ligjore mbi akte rregullatore që përfshinin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përpunimin e të dhënave personale. Në total, janë shqyrtuar 35 projektakte (përfshirë projektvendime, projektligje, projekt marrëveshje dhe udhëzime) dhe janë dhënë 76 opinione ligjore për nisma të ndryshme të kontrolluesve publikë dhe privatë. Ndër projekt-aktet më kryesore për të cilat është dhënë mendim i konsultoni në lidhjen <https://idp.al/viti-2025-dhenie-mendimi-per-projekt-aktet-2/>.

Këto vlerësime kanë synuar garantimin e përputhshmërisë me parimet e përpunimit të të dhënave personale, qartësimin e roleve dhe përgjegjësisë të subjekteve përpunuese, si dhe sigurimin e masave të përshatshme teknike e organizative për mbrojtjen e tyre.



Një pjesë e konsiderueshme e projektakteve të shqyrtuara lidhej me krijimin dhe funksionimin e bazave të të dhënave dhe regjistrave shtetërorë ku Zyra e Komisionerit ka theksuar domosdoshmërinë që çdo përpunim të mbështetet në një bazë të qartë dhe të posaçme ligjore, sipas parimeve kushtetuese dhe kërkesave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Nga analiza e kryer, rezultoi se disa prej projektvendimeve të Këshillit të Ministrave nuk parashikonin në mënyrë të qartë bazën ligjore për përpunimin apo ndërveprimin e sistemeve të të dhënave, duke krijuar pasiguri juridike dhe rrezik për përpunime të paautorizuara. Në këto raste, krijimi dhe funksionimi i bazave përkatëse të të dhënave është mbështetur kryesisht në ligjin nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”. Megjithatë, ky ligj, për shkak të natyrës së tij të përgjithshme, kohës së miratimit dhe nivelit të kufizuar të rregullimit që ofron, nuk mund të konsiderohet si bazë ligjore e mjaftueshme dhe e posaçme për legjitimitimin e çdo qëllimi përpunimi të të dhënave personale, në çdo fushë veprimtarie të institucioneve që ndërtojnë dhe administrojnë këto sisteme.

Sa më sipër, kjo situatë vë në dukje nevojën për rishikim dhe harmonizim të plotë të akteve normative, në mënyrë që krijimi dhe funksionimi i databazave shtetërore të zhvillohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, standardet ndërkombëtare dhe parimet e transparencës, sigurisë dhe proporcionalitetit.

VI. ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

VI.1 PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN

Procesi i integritimit evropian të Shqipërisë përbën një prioritet të qëndrueshëm strategjik në nivel kombëtar, në kuadër të të cilit Zyra e Komisionerit vijon angazhimin e saj të pandërprerë, duke kontribuar dhe raportuar në mënyrë aktive në strukturat përkatëse të negociatave. Zyra është e përfshirë drejtpërdrejt në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga kapitulli “Kriteri Politik”, “Reforma në Administratën Publike”, Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, “Funksionimi i Institucioneve Demokratike” dhe Kapitulli 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Media”. Me përmbushjen e plotë të detyrave të lëna nga Bashkimi Evropian, Zyra e Komisionerit kontribuon në konsolidimin e shtetit të së drejtës dhe garantimin efektiv të të drejtave themelore, në përputhje me kërkesat e procesit të negociatave.

VI.1.1 Dokumenti i Anëtarësimit: Qëndrimi i përbashkët i Bashkimit Evropian

Në vijim të procesit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, gjatë vitit 2025, Zyra e Komisionerit u përqendrua në plotësimin e kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke u angazhuar në hartimin dhe miratimin e 10 akteve nënligjore të cilat u përfunduan brenda një afati të shkurtër kohor.

Përmbushja e këtij detyrimi të lënë nga BE, mori vlerësimin maksimal nga Komisioni Evropian në mbledhjen e 17-të të Nënkomitetit “*Drejtësia, Liria dhe Siguria*”. Ekspertët e lartë përgëzuan gjithashtu Zyrën e Komisionerit për fushatën e gjerë ndërgjegjësuere për mbrojtjen e të dhënave personale me fokus fëmijët. Ata theksuan edhe domosdoshmërinë për zbatimin e rekomandimeve të Komisionerit nga sektori publik dhe privat.

Vëmendje të veçantë ekspertët i kushtuan rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe financiare të Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar strukturave përgjegjëse të angazhohen maksimalisht në mbështetjen dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme të autoritetit.

VI.1.2 Udhërrëfyesit

Zyra e Komisionerit ka vijuar të luajë një rol aktiv dhe të qëndrueshëm në realizimin e masave të përcaktuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës si dhe Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike. Në zbatim të këtyre dokumenteve autoriteti ka ndërmarrë veprime të koordinuara për realizimin e masave të përcaktuara, duke angazhuar kapacitetet e saj administrative dhe teknike për përmbushjen brenda afateve. Paralelisht, janë kryer raportime të rregullta pranë strukturave për monitorimin dhe koordinimin e Udhërrëfyesve, duke garantuar transparencë dhe ndjekje të vazhdueshme të progresit.

VI.1.3 Progres Raporti i Komisionit Evropian

Bashkimi Evropian ka vlerësuar pozitivisht progresin e arritur në procesin e përafrimit të legjislationit për mbrojtjen e të dhënave personale me acquis të BE-së, duke përgëzuar Zyrën e Komisionerit për ecurinë e reformës dhe konsolidimin e kuadrit rregullator. Vlerësimi nuk është kufizuar vetëm në miratimin e ligjit të ri, por ka përfshirë edhe zhvillimet në plotësimin e kuadrit nënligjor dhe forcimin e rolit mbikëqyrës të institucionit. Në të njëjtën kohë, është nënvizuar nevoja për forcimin e kapaciteteve administrative dhe buxhetore të Zyrës së Komisionerit, për të garantuar ushtrim efektiv të kompetencave të saj dhe sigurimin e një mbrojtjeje të qëndrueshme dhe praktike të kësaj të drejte themelore.

Në Progres-Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025, theksohet: “*Kuadri ligjor është adekuat, megjithatë kapacitetet institucionale të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kërkojnë forcim të ndjeshëm, si në aspektin administrativ ashtu edhe në atë buxhetor, për të garantuar zbatimin efektiv të ligjit. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale konsultohet sistematikisht mbi projektligjet që ndikojnë përpunimin e të dhënave personale, dhe rekomandimet e tij respektohen në masë të madhe si nga kontrolluesit publikë ashtu edhe nga ata privatë. Megjithatë, Komisioni Evropian kërkon fushata më të gjera sensibilizimi publik dhe ndërtim të vazhdueshëm kapacitetesh për kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave, me qëllim garantimin e zbatimit të qëndrueshëm të kuadrit ligjor.*”

Rekomandimet e mësipërme, për aq sa janë në kompetencë të institucionit, janë përmbushur duke përafruar të gjithë kuadrin rregullator me *acquis* të BE si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të kontrolluesëve/përpunuesëve publikë dhe privat përmes tryezave, aktiviteteve informuese/edukuese dhe fushatave sensibilizuese.

VI.1.4 Raportime periodike në kuadër të procesit të integritimit

Angazhimi teknik i Zyrës së Komisionerit në kuadër të procesit të integritimit evropian është konkretizuar përmes:

- Pjesëmarrjes aktive në Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) për kapitujt e sipërpërmendur;
- Raportimeve periodike mbi zbatimin e piketës së ndërmjetme të parashikuar në dokumentin e antarësimit për Zyrën e Komisionerit;
- Përgatitjes së kontributit për hartimin e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2025;
- Përfaqësimit dhe raportimit në Nënkomitetin “Drejtësia, Liria dhe Siguria”;
- Përfaqësimit dhe raportimit në Nënkomitetin për Administratën Publike;

VI.2 PJESËMARRJA NË FORUME DHE RRJETE NDËRKOMBËTARE

VI.2.1 Roli i Presidencës dhe Sekretariatit të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit

Falë profesionalizmit dhe korrektesës së treguar gjatë ushtrimit të përkohshëm të Presidencës dhe Sekretariatit të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerve për të Drejtën e Informimit (ICIC), Zyrës së Komisionerit iu rikonfirmua sërish ky rol. Në qershor të vitit 2025, në Konferencën e Berlinit, vendet antare miratuan me unanimitet Komisionerin në rolin e Presidentit të këtij forumi global me një madat 2 vjeçar, duke garantuar kështu vijimësinë e funksioneve institucionale dhe koordinimin e aktiviteteve ndërkombëtare të konferencës. Zgjedhja e Shqipërisë në krye të ICIC konfirmon rolin në rritje të vendit tonë në arenën ndërkombëtare si dhe konsolidimin e transparencës dhe qeverisjen e mirë.



Në këtë rol, Zyra e Komisionerit administron procesin për zgjedhjen e Presidencës dhe Sekretariatit të këtij forumi për periudhën 2025–2027, dhe organizatorin e Edicionit XVIII të kësaj Konference, duke siguruar respektimin e kriterëve dhe afateve. Në drejtim të funksioneve institucionale të ICIC, u zhvilluan 5 takime plenare të Komitetit Ekzekutiv, u administruan platformat e komunikimit dhe rrjetet sociale të ICIC, si dhe u siguroa vazhdimësia funksionale e faqes zyrtare pas tranzicionit të Sekretariatit.

Për Edicionin e XVI të konferencës në Berlin, Zyra udhëhoqi 6 takime të Komitetit të Planifikimit, duke bashkëpunuar me autoritetin Gjerman dhe organizuar takime online për aspekte teknike dhe përgatitore.

Për Edicionin e XVII të këtij forumi global, Zyra e Komisionerit propozoi një qasje gjithëpërfshirëse për anëtarët e Komitetit të Planifikimit, duke përfshirë partnerë ndërkomëbëtar si UNESCO, OECD, çka rezultoi në ngritjen e Komitetit të Planifikimit të Edicionit të XVII dhe zhvillimit të takimit të parë parapërgatitor. Ky Komitet është përgjegjës për planifikimin tematik, paneleve të konferencës, formatit dhe folësve për Sesionin e Hapur.

Në kuadër të zgjerimit dhe konsolidimit të anëtarësisë, u miratua pranimi i 3 anëtarëve të rinj dhe u akordua statusi i vëzhguesit për 4 institucione ndërkombëtare. Për të gjitha këto aplikime, Sekretariati vlerësoi dokumentacionet shoqëruese dhe ndoqi procedurat deri në miratimin nga Komitetit Ekzekutiv i ICIC. Gjithashtu, u krijuan kontakte me 4 rrjete dhe organizata ndërkombëtare për parteneritet në fushën e transparencës dhe të drejtës për informim.

Zyra koordinoi dhe siguroi vijimësinë e grupeve të punës të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerve për të Drejtën e Informimit, duke krijuar grupin e ri për “Integritetin e Informacionit” dhe koordinuar grupet për “Jurisprudencën dhe Trajnimet”. Gjatë kësaj periudhe u zhvilluan gjithsej 8 takime online të grupeve të punës si: Parimet e Aksesit në Informacion, Gjininë dhe Personat në Situata Vulnerabël, Integritetin e Informacionit, Jurisprudencën dhe Trajnimet, ku u mblodhën kontribute konkrete nga autoritetet anëtare dhe u diskutuan prioritetet e ardhshme.

VI.2.2 Berlin – Edicioni XVI i ICIC

Tema kryesore e edicionit XVI të Konferencës së ICIC e mbajtur në Berlin ishte “Aksesi në informacionin mjedisor në epokën digjitale”, duke vënë theksin te nevoja për informim të saktë dhe në kohë për çështje mjedisore, në një epokë kur teknologjia ka transformuar mënyrën se si qytetarët marrin dhe përdorin informacionin publik. Programi i konferencës përfshiu panele të shumta tematike mbi rolin e teknologjisë në përmirësimin e transparencës, sfidat e komisionerëve në garantimin e qasjes në informacion mjedisor si dhe përfshirjen e shoqërisë civile dhe ndarjen e praktikave të mira midis institucioneve homologe.



Gjatë sesionit të mbyllur të konferencës, Zyra e Komisionerit prezantoi progresin e realizuar në zbatimin e Prioriteteve Strategjike të ICIC për periudhën 2024–2027, duke vënë në pah zhvillimet në forcimin e kapaciteteve institucionale, zgjerimin dhe konsolidimin e anëtarësisë, si dhe funksionalizimin dhe kujdesit ndaj punës së grupeve të punës. Në vijim, u miratua edhe Deklarata e Konferencës me titull “*Garantimi i të Drejtës së Informacionit Mjedisor në Epokën Digjitale*”, e hartuar nga Zyra e Komisionerit dhe e konsultuar më parë me anëtarësinë e ICIC. Deklarata reflekton angazhimet e përbashkëta të autoriteteve anëtare për sigurimin e aksesit në informacionin mjedisor, publikimin e të dhënave në mënyrë të kuptueshme dhe të aksesueshme, forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe përdorimin e teknologjisë për rritjen e transparencës dhe informimit publik në fushën e mjedisit.

Konferenca u përmbyll me shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për Presidencën dhe Sekretariatit e ICIC për periudhën 2025–2027. Gjatë punimeve të kësaj konference u vendos krijimi i Rrjeti Evropian për Transparencën dhe të Drejtën e Informimit ku Zyra e Komisionerit është anëtare themeluese si dhe përzgjedhja e Kanadasë si vendi mikpritës i edicionit të ardhshëm.

VI.2.3 Këshilli i Evropës vlerëson zbatimin e Konventës 205 nga Shqipëria

Në cilësinë e organit përfaqësues të Shqipërisë në Këshillin e Palëve, Zyra e Komisionerit mori pjesë në takimin e pestë të Këshillit të Palëve të Konventës së Këshillit të Evropës “Për Aksesin në Dokumentet Zyrtare” (Konventa e Tromsø). Gjatë këtij takimi u vlerësua se ligji shqiptar

për të drejtën e informimit është në përputhje me parimet dhe standardet e përcaktuara në Konventë. Këshilli mirëpriti zbatimin e gjerë të ligjit në autoritetet publike shqiptare, garantimin e qasjes për të gjithë qytetarët pa diskriminim dhe respektimin e parimeve të transparencës dhe qeverisjes së hapur. Pas analizës së legjislacionit shqiptar Grupi i Ekspertëve vlerësoi pozitivisht Shqipërinë në përputhshmërinë me parashikimet e Konventës.

Në të njëjtën kohë, u rekomandua që Shqipëria të përmirësojë më tej dispozitat ligjore për të siguruar përputhshmërinë e përjashtimit mbi sekretin profesional me nenin 3 të Konventës, si dhe përcaktimin e qartë të së drejtës së aplikantit, për të zgjedhur formën e marrjes së dokumenteve zyrtare. Këto rekomandime pritet të kontribuojnë në forcimin e mëtejshëm të transparencës dhe aksesit publik në informacion në vendin tonë.

VI.2.4 Zyra e Komisionerit, anëtare në Grupin e Specialistëve të Konventës 205

Gjatë takimit të pestë të Këshillit të Palëve të Konventës Tromsø, u zgjodhën anëtarët e rinj të Grupit të Specialistëve për Akses në Dokumentet Zyrtare, për një mandat katërvjeçar, që nis më 1 prill 2026. Në mesin e tyre u rizgjodh Drejtori i Përgjithshëm për të Drejtën e Informimit pranë Zyrën e Komisionerit. Ky zhvillim dhe vijimi i angazhimit në nivelin më të lartë të trupës së ekspertëve në Evropë për aksesin në informacion thekson rolin aktiv të Shqipërisë në mekanizmat ndërkombëtarë të monitorimit dhe zbatimit të Konventës.

VI.2.5 Seminar mbi Rastet e Veçanta për të drejtën e informimit

Përfaqësues nga 14 autoritete evropiane për të drejtën e informimit u mbledhën në takimin e 4-t të Seminarit të Rasteve të Veçanta, i cili u zhvillua në Prishtinë. Ekspertët e fushës ndanë me njëri-tjetrin eksperiencat dhe praktikat më të mira mbi shqyrtimin e rasteve konkrete me interes publik dhe aksesin në dokumente zyrtare në lidhje me to. Gjatë aktivitetit u diskutua, për çështje që kanë të bëjnë me transparencën në kuadër të zbatimit të legjislacionit mbi mjedisin dhe të drejtave të konsumatorit, procedurat e shpenzimeve me fondet publike dhe partneritetit publik - privat, ofrimin e shërbimeve publike nëpërmjet platformave teknologjike/digjitale si dhe për trajtimin e sekretit tregtar apo të drejtës së autorit. Në këtë seminar, Zyra e Komisionerit mbajti një prezantim mbi trajtimin e gabuar të konceptit të konfidencialitetit nga autoriteti publik.

VI.2.6 Tryeza Rajonale “Initiative 2020”

Zyra e Komisionerit mori pjesë në takimin rajonal me temë “Initiative 2020”, i cili u zhvillua nga Agjencia për Informim dhe Privatësi të Kosovës. Ky aktivitet bëri bashkë përfaqësues të autoriteteve për të drejtën e informimit nga vendet e Evropës dhe rajonit, me qëllim ndarjen e praktikave dhe eksperiencave më të mira dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e aksesit në dokumentet publike. Në kuadër të aktivitetit, u prezantua roli i ICIC dhe prioritetet strategjike për periudhën 2024–2027. Gjithashtu gjatë kësaj tryeze u paraqit edhe situata e transparencës proaktive në Shqipëri, së bashku me instrumentin e Programit dhe Indeksit të Transparencës.

VI.2.7 Asambleja Globale e Privatësisë

Komisioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Koresë së Jugut ishte mikpritës i edicionit të 47-të të Asamblesë Globale të Privatësisë, eventit më të rëndësishëm vjetor në fushën e mbrojtjes së të dhënave. Temë e këtij forumi global ishte “Inteligjenca artificiale në jetën tonë të përditshme - Çështjet e të Dhënave dhe Privatësisë”. Në këtë aktivitet morën pjesë 130 vende

nga e gjithë bota. Asambleja, trajtoi një gamë të gjerë temash, të lidhura me sfidat e të dhënave personale dhe privatësisë në epokën e inteligjencës artificiale, si dhe hodhi idenë e krijimit të një kuadri qeverisës global për të dhënat personale dhe privatësinë. Në këtë forum global, u zgjodh me votim kryetari i ri i Asamblesë Globale të Privatësisë, si edhe dy anëtarët e rinj të Komitetit Ekzekutiv, përkatësisht nga Autoriteti Gjeorgjian dhe ai Kanadez.



Gjatë punimeve të Asamblesë diskutimet u fokusuan te transferimi ndërkombëtar i të dhënave dhe mbrojtja e të dhënave personale të fëmijëve, në kontekstin e inteligjencës artificiale, akreditimi i anëtarëve dhe vëzhguesve të rinj, ndërtimi i kapaciteteve të autoriteteve mbikqyrëse për mbrojtjen e të dhënave, raporti nga Këshilli i Evropës dhe puna e Komitetit Konsultativ të Konventës 108 etj. Pjesëmarrësit, në këtë asamble patën mundësinë të eksplorojnë evolucionin e teknologjive të reja të inteligjencës artificiale, si dhe përfituan njohuri mbi çështjet komplekse, që sjellin këto inovacione.

VI.2.8 Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit mori pjesë në edicionin e 33-të të Konferencës Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Nën sloganin “*Theuari më i çmuar i një personi është identiteti i tij*” kjo konferencë mbledhi së bashku autoritetet homologe të kësaj fushe për të diskutuar dhe ndarë eksperiencat më të mira për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të qytetarëve. Në këtë aktivitet panelet trajtuan tematika që kishin të bënin me ndërveprimin mes rregulloreve kombëtare për mbrojtjen e të dhënave personale, privatësinë e fëmijëve në mjedise dixhitale, si dhe mbrojtjen e të dhënave shëndetësore në kohë sfidash teknologjike. Anëtarësimi i Kosovës si shtet me të drejta të plota në Konferencën Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale ishte një nga rezultatet pozitive të këtij edicionie.

VI.2.9 Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB)

Zyra e Komisionerit edhe këtë vit është angazhuar në mbledhjet periodike të Bordit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave duke ndjekur nga afër zhvillimet, diskutimet dhe praktikat më të fundit të autoriteteve homologe të BE-së. Ky angazhim i rregullt mbështet përafrimin e praktikave kombëtare me standardet evropiane dhe forcon bashkëpunimin institucional në funksion të zbatimit të qëndrueshëm të kuadrit të mbrojtjes së të dhënave personale.

VI.2.10 Samiti Global i Privatësisë, Shoqata Ndërkombëtare e Profesionistëve të Privatësisë

Zyra e Komisionerit mori pjesë në Edicionin e 25-të të Samitit Global të Privatësisë, organizuar nga Shoqata Ndërkombëtare e Profesionistëve të Privatësisë në Uashington DC. Në kuadër të Ditës së Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave, në këtë samit u diskutua në lidhje me sfidat e mbrojtjes së të dhënave personale, në dritën e bashkëpunimit ndërkombëtar, pavarësinë e autoriteteve mbikëqyrëse, perspektivat e shoqërisë civile, etj. Samiti Global i Privatësisë është një aktivitet ku marrin pjesë profesionistë të fushës si politikëbërësit kryesorë, teknologë, autorë dhe sipërmarrës nga e gjithë bota, të cilët diskutojnë dhe kërkojnë zgjidhje për çështje strategjike dhe sfidat e përditshme në privatësi, qeverisjen e inteligjencës artificiale dhe përgjegjësinë digjitale.



Komisioneri zhvilloi takime me zyrtarë të lartë të institucioneve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me të cilët diskutoi në lidhje me ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri, sfidat si dhe zbatimin e kuadrit për mbrojtjen e të dhënave BE-SHBA.



VI.2.11 Bordi Mbikëqyës për Mbrojtjen e të Dhënave të EUROCONTROL

Zyra e Komisionerit, mori pjesë në mbledhjet e Bordit Mbikëqyrës të Mbrojtjes së të Dhënave të Eurocontrol në Bruksel. Gjatë takimeve Bordi miratoi planin e punës për vitin 2025 si dhe hartimin e raportit të auditit të kërkesave të subjekteve të të dhënave. Në përputhje me dispozitat e Rregullores së Modernizuar për Mbrojtjen e të Dhënave të Eurocontrol, mandati i Shqipërisë në këtë Bord përfundoi në muajin shtator 2025.

VI.2.12 Akademia e Mbrojtjes së të Dhënave

Zyra e Komisionerit mori pjesë për të tretin vit radhazi në Javën e Shkëmbimit dhe Mësimin për Mbrojtjen e të Dhënave, me pjesëmarrje të nivelit të lartë të zhvilluar në Bruksel. Diskutimet u fokusuan në flukset ndërkombëtare të të dhënave, inteligjencën artificiale dhe rolet mbikëqyrëse të autoriteteve, me kontribute nga ekspertë të lartë të DG Justice, Bordit Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Autoritetit Mbikëqyrës Evropian për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Përfaqësues nga vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Partneritetit Lindor ndanë përvoja konkrete mbi sfidat e harmonizimit legjislativ dhe mbikëqyrjes efektive.

VI.2.13 Pjesëmarrje në takimin e punës “European Case Handling Workshop 2025”

Zyra e Komisionerit mori pjesë në ëorkshopin tre ditor “European Case Handling 2025”, e organizuar në Prishtinë, me pjesëmarrjen e 23 autoritete evropiane të mbrojtjes së të dhënave personale. Aktiviteti kishte në fokus forcimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve pjesëmarrëse, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Zyra e Komisionerit ishte pjesë aktive e dy paneleve ku prezantoi kurrikulën për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve në internet, bashkëpunimet ndërinstitucionale me strukturat arsimore në epokën e digjitalizimit si dhe rolin e saj në veprimtarinë administrative të institucioneve shëndetësore.

Gjithashtu, në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare Zyra e Komisionerit, ka marrë pjesë në forume, aktivitete, mbledhje takime, trajnime apo seminare të organizuara nga Komiteti Konsultativ i Konventës 108 të Këshillit të Evropës (T-PD), Grupi Ndërkombëtar i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Teknologji, Mbledhja e Autoriteteve të Evropës Qendore dhe Lindore të Mbrojtjes së të Dhënave si dhe Forumi Internet Freedom.

VII. NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTAVE

VII.1 AKTIVITETET NDËRGJEGJËSUESE DHE DITËT NDËRKOMBËTARE TË TË DREJTAVE

▀ KONFERENCA E VII KOMBËTARE “AGORA E TRANSPARENCËS NË KOHËN E INTEGRIMIT”

Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin organizuan Konferenca e VII Kombëtare për të Drejtën e Informimit, me temë “Agora e transparencës në kohën e integritit”, në përmbyllje të Javës së Integritetit 2025. Kjo konferencë shërbeu si një platformë kombëtare dialogu mbi sfidat e transparencës institucionale në kuadër të procesit të integritetit evropian, duke vënë theksin në rolin mbikëqyrës të Komisionerit, përgjegjësinë e institucioneve publike dhe forcimin e llogaridhënies ndaj qytetarëve.



Gjatë kësaj konference u theksua nga Komisioneri se transparenca përbën një nga shtyllat themelore të qeverisjes së mirë dhe është një element thelbësor për ndërtimin e besimit mes institucioneve dhe publikut. Gjithashtu, transparenca nuk duhet kuptuar thjesht si publikim dokumentesh, por si një kulturë pune, e cila nxit integritetin, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien në çdo hallkë të administratës publike.

Në aktivitetin e organizuar më 17 dhjetor 2025, morën pjesë Kryeministri z. Edi Rama, titullarë dhe përfaqësues të autoriteteve publike në nivel qendror dhe vendor, përfaqësues të trupit diplomatik, sistemit të drejtësisë, shoqërisë civile dhe medias. Në fjalën e tij Kryeministri theksoi se Shqipëria ka ndërtuar një infrastrukturë funksionale për transparencën, duke përmirësuar kapacitetet për qasje në informacion dhe duke promovuar projekte të reja si “Transparent Albania”. Ministrja e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, shprehu vullnetin për të nxitur institucionet qendrore për më shumë transparencë publike. Përfaqësuesit e trupit diplomatik theksuan rëndësinë e forcimit të transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve, ndërsa rikonfirmuan mbështetjen ndaj Shqipërisë në procesin e integritetit si dhe në projekte të ndryshme. Përfaqësuesit e medias dhe shoqërisë civile evidentuan problematikat dhe sfidat në lidhjen me aksesin në informacion.



Problematika kryesore e evidentuar në këtë aktivitet është mosrespektimi i afateve ligjore për kthimin e përgjigjeve, interpretimit të gabuar të kufizimeve ligjore, por shpesh edhe për shkak të neglizhencës. Në përfundim, u theksua se zbatimi i drejtë i ligjit për të drejtën e informimit kërkon angazhim të përbashkët nga institucionet publike, shoqëria civile, media, bota akademike etj.

Gjatë konferencës u prezantuan Modelet e reja të Programit të Transparencës, të hartuara nga Zyra e Komisionerit për institucionet qendrore, të varësisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe gjetjet e raportit vjetor të vetëdeklarimit për vitin 2024.



Po ashtu, u prezantua Manuali Pyetje–Përgjigje për qytetarët, si një instrument praktik për rritjen e aksesit në informacion dhe ndërgjegjësimin mbi të drejtën për informim.



▣ DITA NDËRKOMBËTARE TË SË DREJTËS PËR INFORMIM

Në bashkëpunim me projektin “Bashki të Forta të Helvetas” dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me rastin e 28 – shtatorit, Zyra e Komisionerit organizoi një aktivitet në qytetin e Lezhës kushtuar Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit me pjesëmarrjen e administratës së bashkive dhe këshillave bashkiakë nga qarqet Shkodër, Lezhë, Dibër dhe Kukës. Në fokus të tij ishte prezantimi i modelit të përmirësuar të Programit të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përfshirë rubrikën e këshillave bashkiakë. Në vijim, u zhvilluan takime konsultative në Bashkinë Shijak dhe Pogradec, ku përfaqësues të administratës dhe këshillave bashkiakë diskutuan ndryshimet e propozuara dhe dhanë sugjerime për përmirësimin e transparencës ekonomiko-financiare dhe publikimin e informacionit nga këshillat. Në kuadër të këtij projekti, u hartuan gjithashtu punimet kërkimore “*Transparenca e këshillave bashkiake*” dhe “*Udhëzuesi për monitorimin e transparencës së këshillave bashkiakë*”.

▣ TRAJNIME ME KOORDINATORËT

Gjatë vitit 2025, u zhvilluan 5 cikle trajnimesh të dedikuara për koordinatorët për të drejtën e informimit. Koordinatorët morën njohuri të thelluara për ndryshimet ligjore në fushën e të drejtës për informim si dhe mbi Konventën 205 të Këshillit Evropian “Mbi Aksesin në Dokumente Zyrtare”. Gjithashtu u trajtuan raste praktike nga zbatimi i legjislacionit për të drejtën e informimit. Në përfundim pjesmarrësit u certifikuan nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike duke e çuar numrin e të trajnuarve në 139.

▣ TRAJNIME KOORDINATORË PËR REGJISTRI ELEKTRONIK TË KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

U organizua një trajnim online me koordinatorët për të drejtën e informimit të 25 institucioneve qendrore. Pjesëmarrësit u njohën me detyrimet ligjore për publikimin dhe përditësimin e Regjistrit, funksionet e tij përmes portalit pyetshtetin.al, si dhe praktikat më të mira për trajtimin e kërkesave për informacion në kohë dhe në përmbajtje. Trajnimi synoi forcimin e transparencës proaktive dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe grupeve të interesit.

▣ TRAJNIME KOORDINATORËT E RINJ

U zhvillua një trajnim online me koordinatorët e rinj të 45 autoriteteve publike. Ky trajnim u fokusua në ndryshimet ligjore dhe zbatimin praktik, përfshirë publikimin dhe përditësimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve përmes Regjistrit në portalin pyetshtetin.al. Zyra do të vazhdojë mbështetjen me trajnime periodike për rritjen e njohurive mbi transparencën dhe llogaridhënien institucionale.

▣ MANUALI PËR QYTETARËT

Për ti ardhur në ndihmë qytetarëve, mbi kuptueshmërinë e ligjit për të drejtën e informimit është përgatitur “*Manuali shpjegues i të drejtës për informim*”, i konceptuar në formë pyetje-përgjigje. Përmes një gjuhe të qartë ky dokument sjell informacion lehtësisht të kuptueshëm mbi të drejtën dhe aksesin në informacion.

▣ NEWSLETTER

Neësletter-i “Për të drejtën e informimit” ofron një përmbledhje mujore të veprimtarive të institucionit dhe monitorimit të zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit. Ai shpërndahet çdo muaj përmes faqes zyrtare të Zyrës së Komisionerit, si dhe tek koordinatorët dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

▣ DITA NDËRKOMBËTARE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Zyra e Komisionerit, me rastin e 28 Janarit, Ditës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, organizoi një aktivitet ndërgjegjësues mbi rëndësinë e respektimit të privatësisë, ruajtjes dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Aktiviteti u zhvillua në gjimnazin “Sami Frashëri” dhe mbledhi bashkë drejtues të shkollave të arsimit të mesëm të lartë, mësues, nxënës dhe prindër. Këto takime kishin në fokus rëndësinë e ndërgjegjësimit të të rinjve për sigurinë e të dhënave personale, si edhe qasjen e ruajtjen e këtyre të dhënave edhe përballë ekspozimit që mund të sjellë teknologjia. Pjesë e diskutimeve ishin rastet e cënimit të privatësisë online, bulizmi kibernetik, mesazhet keqdashëse në telefon, përdorimi pa leje i fotografive apo të dhënave të tjera personale, si edhe problematika të tjera që kanë të bëjnë me nevojën për mirëinformim dhe rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale. Gjithashtu, në kuadër të kësaj dite, Komisioneri zhvilloi një leksion të hapur me studentët e Institutit Kanadez të Teknologjisë. Njohja me fushat e veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit ishin temë e këtij leksioni.

▣ MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE NË SEKTORIN BANKAR

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zhvilloi një takim me drejtuesit e institucioneve bankare dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave, me fokus zbatimin e legjislacionit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale.



Takimi synoi të forconte dialogun sektorial me bankat, të cilat janë ndër kontrolluesit dhe përpunuesit më të mëdhenj të të dhënave personale, dhe të identifikonte mundësi për përmirësime në praktikat ekzistuese. Drejtuesit e bankave vlerësuan dialogun e hapur dhe konfirmuan angazhimin për konsolidimin e bashkëpunimit me Zyrën e Komisionerit.

▣ MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE NË SEKTORIN E SIGURUESËVE

Zyra e Komisionerit zhvilloi një tryezë pune me Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë dhe drejtues të kompanive të sigurimeve, me fokus zbatimin në praktikë të ligjit të ri nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Diskutimet u përqendruan gjithashtu te risitë e ligjit të ri, detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve, transparenca ndaj subjekteve të të dhënave, roli i Nëpunësit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe mundësia e hartimit të dokumenteve të unifikuara apo një Kodi Sjelljeje për sektorin e sigurimeve.

▣ MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE TE TË MITURIT DHE VIKTIMAT E TRAFIKIMIT

Zyra e Komisionerit zhvilloi një aktivitet informues dhe ndërgjegjësues me fokus zbatimin e detyrimeve ligjore për përpunimin e sigurt të të dhënave personale të të miturve dhe viktimave të trafikimit, si dhe promovimin dhe respektimin e privatësisë në çdo fazë të procesit administrativ. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues dhe ekspertëve të institucioneve shtetërore, organizatave jofitimprurëse dhe strukturave që veprojnë në fushën e parandalimit të trafikimit dhe mbrojtjes së fëmijëve. U theksua domosdoshmëria e rritjes së standardeve për mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit dhe të drejtave të fëmijëve, si disa nga kategoritë e subjekteve të të dhënave më sensitive. Takimi u shoqërua me diskutime të hapura mbi forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe roli i tyre në promovimin e përpunimit të sigurt të të dhënave personale.



Zyra e Komisionerit theksoi angazhimin e vazhdueshëm për monitorimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave të kategorive vulnerabël, si pjesë e përpjekjeve kombëtare për parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e të miturve.

▣ MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE NË MJEDISIN DIGJITAL

Në kuadër të fushatës ndërkombëtare “16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore”, me ftesë të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Zyra e Komisionerit mbajti në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, një leksion të hapur mbi sigurinë digjitale dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore në internet. Aktiviteti u fokusua në sfidat aktuale të sigurisë në internet, rreziqet që lidhen me shpërndarjen e të dhënave personale, format e dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale dhe masat praktike që studentët mund të ndërmarrin për të mbrojtur veten dhe të drejtat e tyre, në raport me detyrimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

VII.2 BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE

Ndërveprimi me organizatat e shoqërisë civile dhe median përbën një rëndësi të veçantë për institucionin. Si partnerë në funksion të interesit publik me qëllim rritjen e transparencës, Zyra e Komisionerit ka kontribuar dhe bashkëpunuar me grupet e interesit në zhvillimin dhe pjesëmarrjen aktive për projekte dhe iniciativa të ndryshme. Për rrjedhojë, gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit ka organizuar aktivitetet si më poshtë:

- Takimin e përvitshëm me përfaqësues të shoqërisë civile dhe medias investigative, për të pasqyruar veprimtarinë e institucionit gjatë vitit paraardhës dhe për të forcuar bashkëpunimin në promovimin e llogaridhënies dhe transparencës së autoriteteve publike. Gjatë takimit u prezantua raporti paraprak *“Mbi vlerësimin bazë për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për aksesin në dokumentet zyrtare nga Shqipëria”* dhe u diskutua mbi sfidat në sigurimin e informacionit nga autoritetet publike. Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe medias vlerësuan punën e Zyrës së Komisionerit dhe sugjeruan mekanizma për thjeshtimin e zbatimit të ligjit, me qëllim ofrimin e informacionit të plotë dhe në kohë nga institucionet.
- Ka marrë pjesë më takimin e grupeve tematike mbi qasjen në informacion, në kuadër të projektit *“Promovimi i Lirisë së Shprehjes në Shqipëri përmes Dialogut të Hapur”*, i bashkëfinancuar nga BE/Këshilli i Evropës dhe Universiteti i Tiranës. Diskutimet u fokusuan në shkëmbimin e përvojave, situatën aktuale dhe rekomandimet për përmirësimin e aksesit në informacion. Zyra e Komisionerit kontribuon gjithashtu në ngritjen e Platformës së Dialogut për Median, e cila do të përqendrohet në zbatimin e rekomandimeve të dokumentit të politikave *“Përshtatja e Peizazhit Mediatik të Shqipërisë me Standardet Evropiane: Reformat Ligjore dhe Institucionale mbi Përqendrimin, Transparencën, Rregullimin e Medias dhe Median e Shërbimit Publik”*.
- Në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri dhe me mbështetjen e Bashkimit Europian, organizoi takimin e dytë të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian, i fokusuar në zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në këto aktivitete morën pjesë përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve publike, mediave, akademisë dhe ekspertë të huaj të cilët ndanë praktika të mira mbi transparencën dhe mbrojtjen e të dhënave.
- Me ftesë të shoqatës *“Together for Life”*, autoriteti ka qenë i angazhuar dhe ka kontribuar në disa takime të zhvilluara gjatë zbatimit të projektit *“Forcimi i demokracisë pjesëmarrëse përmes fuqizimit të shoqërisë civile - SPACE”* të financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Together for Life, në bashkëpunim me BIRN Albania, Qëndresa Qytetare dhe Destiny for Civil Empowerment (DCE), përgjatë gjithë vitit 2025.
- Ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë *“Shoqëria civile për shëndetësi cilësore dhe arsim të barabartë- Transformimi i komuniteteve në Shqipëri”*, si dhe në takimin përmbyllës *“Transparenca dhe aksesueshmëria në sistemin shëndetësor dhe arsimor”*.
- Me ftesë të shoqatës *“Together for Life”* autoriteti mori pjesë në tryezën me temë *“Vizioni për një shëndetësi pa korrupsion: mekanizmat administrativë të trajtimit të ankesave”*. Në fokus të saj ishte domosdoshmëria për forcimin e praktikave të mira në luftën kundër korrupsionit në sektorin shëndetësor, për të avancuar sa më shumë transparencën, integritetin dhe ndërtimin e një sistemi më të drejtë për të gjithë.

VIII. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE

VIII.1 AKTE RREGULLATORE

VIII.1.1 Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 124/2024

Në zbatim të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Zyra e Komisionerit hartoi dhe miratoi 10 akte nënligjore të cilat plotësojnë dhe forcojnë kuadrin rregullator të kësaj fushe si rrisin sigurinë juridike për kontrolluesit/përpunuesit e të dhënave në përputhje me standardet ndërkombëtare.

1. Vendim nr. 01, datë 30.04.2025 “Për përcaktimin e shteteve që sigurojnë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”

Vendimi përcakton shtetet që sigurojnë një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, duke përfshirë, shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, vendet e Zonës Ekonomike Evropiane që zbatojnë Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe shtetet që janë palë në Konventën 108 të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”. Akti lehtëson transferimin e të dhënave personale kur ato transferohen në ndonjë nga vendet e listuara në Ankesin nr. 1 të vendimit. Gjithashtu, ky akt pasqyron njohjen reciproke midis Shqipërisë dhe Kosovës në lidhje me të drejtën për të transferuar të dhëna personale, duke i njohur të dy vendet me nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave personale.

2. Udhëzim nr. 01, datë 30.04.2025, “Për masat e sigurisë për të dhënat personale në fushën e arsimit”

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e masave të sigurisë dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të dhënave personale në fushën e arsimit. Udhëzimi përcakton rregulla të veçanta që institucionet arsimore që duhet të zbatojnë për mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve, studentëve dhe të gjithë atyre që janë regjistruar në një institucion arsimor.

3. Udhëzim nr. 02, datë 30.04.2025 “Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore”

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë përpunimin e të dhënave personale, të dhënave të sensitive dhe të dhënave gjenetike që lidhen me shëndetin, me qëllim sigurimin e respektimit të të drejtave themelore të individëve, në veçanti të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky akt zbatohet për personat fizikë dhe juridikë që kryejnë aktivitete në sektorin e kujdesit shëndetësor, si dhe për përpunuesit që veprojnë në emër të tyre.

4. Udhëzim nr. 03, datë 30.04.2025 “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video survejimit”

Ky udhëzim ka për qëllim të sigurojë përpunimin e ligjshëm dhe transparent të të dhënave personale përmes sistemeve të mbikëqyrjes me video, në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale. Të dhënat e ruajtura nga sistemet e mbikëqyrjes me video (imazhe, tinguj) konsiderohen të dhëna personale, përmes të cilave një individ mund të identifikohet

drejtpërdrejt ose tërthorazi. Instalimi dhe menaxhimi i sistemeve CCTV duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Udhëzim nr. 04, datë 30.04.2025 “Për mbrojtjen e të dhënave personale dhe masat e duhura të sigurisë në marketingun e drejtpërdrejtë”

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat që duhet të ndjekin kontrolluesit ose përpunuesit e të dhënave personale kur kryejnë marketing të drejtpërdrejtë. Gjithashtu, ky udhëzim synon të sigurojë që përpunimi i të dhënave personale për qëllime marketingu të kryhet në përputhje me detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 124/2024.

6. Udhëzim nr. 05, datë 16.07.2025 “Për përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente”

Ky udhëzim përcakton rregulla të qarta për përpunimin ligjor të të dhënave personale nga autoritet që janë kompetente për parandalimin, hetimin, zbulimin ose ndjekjen e veprave penale si dhe ekzekutimin e dënimeve penale dhe për çështje të sigurisë publike e kombëtare. Në mënyrë specifike, ky dokument zbatohet për të gjitha përpunimet e të dhënave personale, që kryhen nga ana e Autoriteteve Kompetente. Gjithashtu ky akt parashikon respektimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave si dhe marrjen e masave të sigurisë duke përfshirë edhe vlersimin e ndikimit të dhënave kur ka rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave.

7. Udhëzim nr. 06, datë 16.07.2025 “Për miratimin e metodologjisë për përllogaritjen e masës së sanksioneve administrative”

Qëllimi i këtij udhëzimi është mundësimi i metodologjisë për një aplikim të drejtë, transparent dhe proporcional të përllogaritjes së vlerës së masës së sanksionit. Ky dokument përcakton hapat për vlerësimin e shkeljes, duke marrë parasysh rrethanat konkrete të çdo rasti si: natyra e shkeljes, qëllimi, si dhe rëndësia e të dhënave personale që janë prekur.

8. Udhëzim nr. 07 , datë 20.11.2025 “Për mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, elektronike dhe/ose audiovizive si dhe përjashtimet për qëllimet e posaçme të përpunimit”

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë përpunimin e të dhënave personale nga media e shkruar, elektronike dhe/ose audiovizive, duke vendosur rregulla të qarta për balancimin e lirisë së shprehjes dhe të së drejtës për informim me mbrojtjen e jetës private dhe të të dhënave personale. Akti trajton, përpunimin e të dhënave sensitive, mbrojtjen e të miturve, raportimin mbi çështjet penale, përdorimin e imazheve dhe pajisjeve të regjistrimit, si dhe ushtrimin e së drejtës për t’u harruar, duke përcaktuar gjithashtu rastet dhe kushtet në të cilat disa detyrime ligjore mund të përjashtohen për qëllime gazetareske, në përputhje me ligjin nr. 124/2024.

9. Udhëzim nr. 08, datë 20.11.2025 “Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues”

Ky udhëzim synon të përcaktojë kriteret dhe procedurat shtesë për akreditimin e organeve të certifikimit të të dhënave personale, duke vendosur kërkesa lidhur me pavarësinë, paanshmërinë, konfidencialitetin, përgjegjshmërinë, kompetencën teknike dhe ligjore, si dhe kapacitetin e burimeve, në përputhje me ligjin nr. 124/2024 dhe standardin ISO/IEC 17065.

10. Udhëzim nr. 09, datë 20.11.2025 “Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale”

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë kriteret e përgjithshme ligjore, teknike dhe organizative për certifikimin e veprimeve të përpunimit të të dhënave personale dhe për dhënien e vulave dhe shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr. 124/2024 dhe standardet ndërkombëtare përkatëse (përfshirë ISO/IEC 27001 dhe ISO/IEC 27701). Gjithashtu, përcakton kushtet, procedurat dhe përgjegjësitë për kontrolluesit dhe përpunuesit që kërkojnë certifikim.

VIII.1.2 Udhëzimi nr. 463/2020

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, ka përditësuar Ankesin I të Udhëzimit të përbashkët nr. 463/2020 “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga Shërbimi i Gjendjes Civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, i ndryshuar, duke shtuar institucionet të cilat kanë depozituar kërkesën për t’u bërë pjesë e tij.

VIII.2 DOKUMENTE STRATEGJIKE

VIII.2.1 Strategjia Institucionale dhe Plani i Integritetit 2022-2025

Për vitin 2025, Zyra e Komisionerit ka përmbushur me sukses masat e parashikuara në planin e Veprimit të Strategjisë Institucionale dhe Planit të Integritetit 2022 – 2025, duke siguruar zbatimin e objektivave dhe funksionimin institucional. Në përfundim të këtyre dy dokumenteve, Zyra e Komisionerit ka nisur procesin e draftimit të dokumentave të reja për periudhën 2026-2030.

VIII.2.3 Strategji Ndërsektoriale

Zyra e Komisionerit është përfshirë në disa strategji ndërsektoriale nëpërmjet zbatimit të objektivave që lidhen me fushën e veprimtarisë së saj.

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030

Institucioni ndjek zbatimin e sfidës “Mbrotjtja e të dhënave të qytetarëve sipas standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave dhe forcimi/promovimi i transparencës proaktive me qëllim rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike”, në kapitullin “Forcimi i të drejtave të njeriut”.

- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Indikatorëve

Institucioni ka zbatuar dhe raportuar mbi masën “*Fushata ndërgjegjësuese kombëtare për promovimin e të drejtave të fëmijëve me qëllim parandalimin e viktimizimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe diskriminimi i fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin*” për sa i përket përmbushjes së aktivitetit “*Fushatë kombëtare ndërgjegjësuese me fokus promovimin e mbrojtjes së të dhënave personale të fëmijës, veçanërisht të fëmijëve viktimë, të fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin, si dhe në sistemin arsimor të vendit (mësues, nxënës, student, staf akademik/administrative)*”.

- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024 – 2030, Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Indikatorëve

Institucioni ka zbatuar dhe raportuar mbi objektivin “*Forcimi i bashkëpunimit efektiv të institucioneve të sistemit të drejtësisë për realizimin e ELP dhe rritja e aksesit të qytetareve në informacionin mbi kuadrin ligjor dhe sistemin e drejtësisë*”, për sa i përket përmbushjes së masës: “*Fushata ndërgjegjësuese dhe edukuese për publikun mbi legjislacionin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale*”.

- Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030 dhe Plani i Veprimit

Institucioni ka zbatuar dhe raportuar mbi masën “*Sigurimi i të drejtës së viktimës për mbrojtje dhe njohja e viktimave me nevoja specifike mbrojtje gjatë procedimeve penale*”, për realizimin e aktivitetit “*Organizimi i trajnimeve, ëorkshop-eve me qëllim rritjen e aftësive të profesionistëve mbi zhvillimin me përgjegjshmëri të proceseve të përpunimit të të dhënave personale dhe mbi detyrimet e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale për viktimat e krimit*”.

- Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 dhe Plani i Veprimit 2024-2026

Institucioni ka zbatuar dhe raportuar mbi objektivin “*Identifikimi i nevojave për përmirësimin e burimeve njerëzore, teknike dhe financiare të institucioneve përgjegjëse për parandalimin e korrupsionit*”, “*Forcimi i transparencës së institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes*” dhe “*Fuqizimi i mekanizmave për parandalimin efektiv të korrupsionit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore*”.

- Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2025 – 2030 dhe Plani i Veprimit 2025 – 2027

Institucioni ka zbatuar dhe raportuar mbi masat: “*Miratimi i legjislacionit dytësor në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe “Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të institucioneve të administratës publike për zbatimin efikas të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik nga institucionet kryesore*”.

- Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Plani i Veprimit

Institucioni ka zbatuar dhe raportuar mbi përmbushjen e objektivit “Menaxhimi migracionit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe institucional”, “Fushatë ndërgjegjësuese me punonjës policie, psikolog, inspektorë të punës, punonjës të policisë të kufirit dhe stafit të autoriteteve kombëtare që mbulojnë çështjet e azilit dhe migracionit me fokus zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale”, “Hartimi dhe rishikimi i politikave të migracionit bazuar në të dhëna të sakta dhe të koordinuara”, si dhe “Zhvillimi i trajnimeve për realizimin me përgjegjshmëri të proceseve të përpunimit, shkëmbimit dhe ndërveprimit të të dhënave personale, me qëllim rritjen e aftësive të nëpunësve të ngarkuar me mbledhjen e të dhënave të migracionit.”

- Strategjia Kombëtare kundër ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimit 2025 – 2030

Institucioni është përgjegjës për përmbushjen e objektivit “Ngritje dhe konsolidim i kapaciteteve institucionale për të parandaluar, për të zbuluar dhe për të analizuar ndërhyrjet e huaja në fushatat zgjedhore”, “Hartimi i një plani emergjent për reagimin ndaj sulmeve kibernetike”, “Hartimi i një plani emergjent për reagimin ndaj sulmeve kibernetike”, “Rregullimi i veprimtarisë së palëve të treta në fushatat zgjedhore”, “Përmirësimi i rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe objektivi III “Mbrojtja e ekonomisë kombëtare dhe e sektorëve të tjerë kritikë” dhe “Miratimi i ligjit për shqyrtimin e investimeve të huaja”.

- Agjenda Kombëtare e të Drejtave të Fëmijëve 2021–2026

Institucioni ka zbatuar dhe raportuar mbi objektivin “Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale”.

VIII.3 PROCESË GJYQËSORE

VIII.3.1 Çështje me objekt zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”

Zyra e Komisionerit ka qenë palë në 31 procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për çështje me objekt legjislacionin për të drejtën e informimit.

<i>Specifikat e Çështjes</i>	<i>Transparenca Proaktive</i>	<i>Aksesi në informacion</i>
<i>Procese gjyqësore</i>	1	30
<i>Rrëzim padie</i>	0	5
<i>Pranim padie</i>	1	2
<i>Pranim i pjesshëm i padisë</i>	0	2
<i>Pushim gjykimi për Zyrën e Komisionerit</i>	0	3
<i>Çështje e kthyer për mangësi në kërkesë padi</i>	0	2
<i>Çështje të pezulluara</i>	0	1
<i>Çështje në proces</i>	0	15

Bazuar në të dhënat statistikore të raportuara në tabelën e mësipërme, rezulton se nga 16 procese gjyqësore të përfunduara gjatë vitit 2025, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë

ka pranuar 3 padi, 2 pjesërisht si dhe janë rrëzuar 5 të tjera. Nga ndjekja e proceseve gjyqësore që lidhen me vendimet e Komisionerit në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, rezulton se gjykata në shumicën e rasteve, ka vendosur rrëzimin e gjobës ndaj personave përgjegjës, duke lënë në fuqi themelin e vendimit urdhërues. Në këto raste, është konstatuar shkelja e ligjit, por është shfuqizuar masa administrative me gjobë. Në disa raste të tjera, gjykata ka vlerësuar se dhënia e informacionit pas vendimit të Komisionerit përbën përmbushje të detyrimeve ligjore, duke shfuqizuar sërish masën administrative me gjobë. Kjo qasje e gjykatës, rrezikon të krijojë një interpretim të gabuar nga ana e autoriteteve publike. Një interpretim i tillë mund të çojë në perceptimin e zbatimit fakultativ ose jo të parashikimeve të ligjit si dhe të vendimeve urdhëruese të Komisionerit në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e ligjvënësit.

VIII.3.2 Çështje me objekt zbatimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit ka qenë palë në 20 procese gjyqësore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, për çështje me objekt legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

<i>Specifikat e Çështjes</i>	<i>Numri i rasteve</i>
<i>Procese gjyqësore</i>	20
<i>Pranim padie</i>	1
<i>Rrëzim padie</i>	13
<i>Pranim i pjesshëm i padisë</i>	1
<i>Çështje në proces</i>	5

Në 13 prej këtyre çështjeve, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadiës, duke lënë në fuqi vendimmarrjen e Komisionerit. Për një të tjetër, gjykata ka vendosur pranim të pjesshëm të padisë. Vlen të theksohet se, vetëm në një rast, gjykata ka vendosur pranimin e padisë. Deri në dhjetor 2025, 5 çështje të tjera vijojnë të jenë ende në proces shqyrtimi nga ana e gjykatës. Zyra e Komisionerit ka qenë palë në 101 procese gjyqësore të akumuluar ndër vite në shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Gjatë vitit 2025, kjo gjykatë është shprehur me vendim për 5 çështje, ndërsa 96 të tjera vijonë në proces.

Zyra e Komisionerit ka hasur problematika lidhur me vendime e nxjerra prej saj, të cilat ankimohen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe merren në shqyrtim nga kjo e fundit. Nga praktika gjyqësore është konstatuar një vonesë e konsiderueshme në zbardhjen e vendimeve të arsyetuara, si edhe në nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit pas shpalljes së tyre në seancë gjyqësore. Këto vonesa kanë krijuar pasojat e drejtpërdrejta në procesin e ekzekutimit të sanksioneve administrative, veçanërisht në vjeljen e gjobave. Situata e përsëritur ka sjellë risk real për parashkrimin e dënimeve administrative me gjobë, në kuptim të ligjit nr. 10 079, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Kjo situatë cenon drejtpërdrejt parimin e efektivitetit të masave administrative, sigurinë juridike dhe funksionin parandalues të sanksionit administrativ. Zvarritja e shqyrtimit gjyqësor dobëson zbatueshmërinë reale të vendimeve administrative, cenon autoritetin e institucioneve rregullatore dhe krijon premisa për sjellje abuzive nga subjektet e sanksionuara.

Në këto kushte, propozohet që çështjet që lidhen me kundërshtimin e sanksioneve administrative të përfshihen në kategorinë e çështjeve që shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar gjyqësore. Kriteri objektiv për përfshirjen në procedurë të përshpejtuar mund të lidhet me kalimin e një afati të konsiderueshëm kohor nga data e vendosjes së sanksionit administrativ, duke pasur parasysh se vonesat procedurale rrezikojnë seriozisht realizimin e qëllimit të masës ndëshkimore dhe interesin publik për ekzekutimin efektiv të saj. Një zgjidhje e tillë nuk kërkon ndërhyrje në kuadrin ligjor material apo procedural ekzistues, pasi kategorizimi i çështjeve që shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar realizohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në ushtrim të kompetencave të tij për organizimin dhe administrimin e veprimtarisë gjyqësore. Kjo qasje garanton një ndërhyrje fleksibël, të shpejtë dhe të harmonizuar në nivel sistemi, pa qenë e nevojshme ndërhyrja në ligjet sektoriale apo në Kodin e Procedurës Administrative. Përfshirja e këtyre çështjeve në procedurë të përshpejtuar do të kontribuonte në rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë administrative, në forcimin e zbatueshmërisë së sanksioneve administrative dhe në garantimin e një ekuilibri të drejtë ndërmjet së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe interesit publik për ekzekutimin efektiv të vendimeve administrative.

IX. MENAXHIMI BUXHETOR

IX.1 STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Zyra e Komisionerit, për vitin 2025, ka funksionuar mbi bazën e së njëjtës strukturë organizative, të miratuar nga Kuvendi i Republikës të Shqipërisë me Vendimin nr. 86/2018 *“Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.

Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit është përballur me sfida të ndjeshme lidhur me kapacitetet njerëzore, në funksion të zbatimit efektiv të legjislacioneve në fuqi, veçanërisht në kushtet e ndryshimeve ligjore, rritjes së përgjegjësisë institucionale, shtimit të proceseve raportuese, si dhe zgjerimit të kompetencave të fushës së veprimtarisë institucionale. Ndryshimet dhe përditësimet e legjislacioneve, kanë rritur ndjeshëm volumin dhe kompleksitetin e punës, duke krijuar mospërputhje të qartë midis ngarkesës funksionale dhe kapaciteteve aktuale të stafit. Për këtë arsye, institucioni për vitin 2025, i është drejtuar Ministrisë së Financave për shtimin me 10 punonjës në organikë ose gjetjes së një alternative tjetër për zgjidhjen e situatës dhe përballimin e fluksit të punës. Me gjithë arsyet objektive dhe argumentet e shtruara nga Zyra e Komisionerit, kërkesa nuk u miratua.

Gjithashtu në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Zyra e Komisionerit ka kërkuar një shtesë me 22 punonjës më shumë në organikë për vitin 2026. Nga këto, u miratuan vetëm 5 punonjës shtesë me ligjin nr.87/2025 *“Për buxhetin e vitit 2026”*, duke e çuar numrin total të punonjësve në 65 për vitin 2026. Nevoja për rritje të mëtejshme të burimeve njerëzore, mbetet një çështje për tu adresuar në vijim, në funksion të përmbushjes sa më efektive të misionit dhe detyrimeve ligjore të institucionit.

Me ligjin e ri nr. 124/2024 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, Komisioneri miraton strukturën dhe organikën e institucionit. Në këtë kuadër, me Urdhërin nr. 21, datë 30.01.2026 u miratua struktura dhe organika e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Rëndësi i është kushtuar zhvillimit të kapaciteteve profesionale, ku pjesëmarrja e stafit në trajnime dhe aktivitete ka kontribuar në rritjen e njohurive, aftësive dhe performancës në punë. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2025, institucioni ka planifikuar dhe realizuar pjesëmarrjen në trajnime të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, si dhe nga institucione dhe partnerë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Në kuadër të plotësimit të strukturës, referuar planit vjetor të rekrutimeve për vitin 2025, janë ndjekur 10 praktika administrative për menaxhimin e marrëdhënieve të punës në përputhje me legjislationin në fuqi. Mungesa e plotësimit të strukturës ka ardhur si rezultat i lëvizjeve të stafit apo procedurave të rekturimit pa fitues.

IX.2 MENAXHIMI I BUXHETIT

Me ligjin nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, fondet e akorduara për Zyrën e Komisionerit ishin në vlerën 169.950.000 lekë. Buxheti i Zyrës së Komisionerit, për vitin 2025, me ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, konkludon të jetë në vlerën totale prej 159.450.000 lekë. Në kuadër të pavarësisë së menaxhimit të buxhetit, por edhe në zbatim të transparencës mbi përdorimin e fondeve buxhetore, në tabelën e mëposhtme pasqyrohet në %, çdo kategori shpenzimesh, përkundrejt totalit të buxhetit, si dhe niveli i realizimit të fondeve buxhetore të Zyrës së Komisionerit në % dhe vlerë, për secilën kategori shpenzimesh, përkundrejt buxhetit të akorduar.

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Plani vjetor 2025, i ndryshuar</i>	<i>Struktura në përqindje kundrejt totalit</i>	<i>Fakti vjetor</i>	<i>% realizimi kundrejt planit vjetor për kategori</i>
1	Paga	97.140.000	63.1%	96.609.823	99.4 %
2	Sigurime shoqërore	15.330.000	9.9%	14.966.472	97.6 %
3	Mallra e shërbime të tjera	32.740.000	19.3%	28.471.795	87 %
4	Investime	13.000.000	7.4 %	0	0 %
5	Transferta te buxhetet familjare	1.090.000	0.1%	748.049	68.7 %
6	Kuotizacion	150.000	0.1 %	108.280	72 %
	Totali	159.450.000	100 %	140.904.419	88.4 %

Fondet e vëna në dispozicion të Zyrës së Komisionerit, janë realizuar në shumën prej 140.904.419 lekë, ose në nivelin 88.4 % ndaj planit të miratuar. Ky nivel realizimi nuk lidhet me mungesë planifikimi apo menaxhimi buxhetor për shpenzime të çdo kategorie, por dëshmon përdorimin ekonomik, eficient të fondeve publike, në përputhje me parimet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Niveli i zbatimit të buxhetit për vitin 2025, në disa zëra buxhetorë, është më i ulët nga viti i kaluar, si rezultat i kombinimit të disa faktorëve procedural, organizativ dhe objektivë. Ndër arsyt kryesore përmendim:

- zgjatja e zhvillimit të procedurave të prokurimit për shkak të ushtrimit të së drejtës së ankimit nga operatorët ekonomikë;
- perioda kohore e pritjes së shqyrtimit të ankesave administrative, të cilat kanë ndikuar në pamundësinë e realizimit/përfundimit të shpenzimeve/investimit brenda vitit buxhetor, duke sjellë anulim të procedurës së prokurimit;
- gabimeve procedurale/njerëzore dhe administrative të Degës së Thesarit, Tiranë gjatë procesit të trajtimit të dokumentacionit dhe miratimit për likujdim në Ministrinë e Financave dhe kalimin e saj në llogarinë e subjektit kontraktor. Kjo ndikoi në mos

ekzekutimin e pagesës së investimit të kryer brenda afatit të mbylljes së vitit buxhetor 2025.

- rezultate të drejtpërdrejta të prodhimit të efekteve pozitive të procedurave të rregullta të prokurimit nëpërmjet menaxhimit të kujdesëm financiar dhe zbatimit eficient të procedurave;
- racionalizimit të shpenzimeve për shërbime dhe furnizime.

Fondi i veçantë është një tjetër zë shpenzimi, i cili ndikon në rezultatin final të përdorimit të buxhetit 2025. Mosrealizimi i fondit të veçantë ka ardhur si pasojë e mungesës së nevojës reale për përdorimin e tij si dhe e mungesës së situatave të paparashikuara që do të kërkonin aktivizimin e tij.


IX.3 ARKËTIME NGA SANKSIONET

Për vitin 2025 sanksionet administrative të vendosura, janë në shumën 5 350 000 lekë. Ekzekutimi i sanksioneve arkëtohet 100% në buxhetin e shtetit, duke u shlyer vullnetarisht ose nëpërmjet shërbimit përmbarimor.

Totali i sanksioneve në vitin 2025	5 350 000 lekë
Për shkelje të dispozitave ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale	4 700 000 lekë
Për shkelje të dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit	650 000 lekë

Për vitin 2025, shuma totale e arkëtimit të sanksioneve administrative është në vlerën 1 310 000 lekë, përta i përket detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme.

ANEKS 1 - STRUKTURA DHE ORGANIGRAMA



**ORGANIKA DHE KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS TË ZYRËS SË
KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE**

Funksioni	Nr. i punonjësve	Kategoria/Klasa
I. Komisioneri	1	Ligji nr. 9584, datë 17.07.2006, i ndryshuar
II. Kabineti	4	VKM 325, datë 31.05.2023, i ndryshuar
Drejtor	1	I – 3
Këshilltar	3	I – 4
III. Sekretar i Përgjithshëm	1	I – 2
IV. Drejtoria e Auditit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale		(3)
Drejtor	1	II – 1
Inspektor	2	III – 1
V. Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit		(15)
Drejtor i Përgjithshëm	1	I – 4
V/I. Drejtoria e Monitorimit të Programeve të Transparencës		
Drejtor	1	II – 1
Inspektor	5	III – 1
V/II. Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave		
Drejtor	1	II – 1
Inspektor	5	III – 1
V/III. Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik		
Inspektor	2	III – 1
VI. Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale		(20)
Drejtor i Përgjithshëm	1	I – 4
VI/I. Drejtoria e Vlerësimit të Ankesave dhe Harmonizimit		
Drejtor	1	II – 1
Inspektor	6	III – 1
VI/II. Drejtoria e Hetimit Sektorial dhe Sigurisë së të Dhënave		
Drejtor	1	II – 1
Inspektor	6	III – 1

VI/III. Drejtoria e Mbikëqyrjes në Fushën e Drejtësisë Penale dhe Sigurisë**Publike**

Drejtor	1	II – 1
Inspektor	4	III – 1

VII. Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Integritit (7)

Drejtor	1	II – 1
---------	---	--------

VII/I Sektori Rregullator, Integritit dhe Procedurave Administrative

Inspektor	3	III – 1
-----------	---	---------

VII/II Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Shef sektori	1	III – 1
Specialistë	2	IV – 1

VIII. Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës (14)

Drejtor	1	II – 1
---------	---	--------

VIII/I. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun

Shef sektori	1	III – 1
Specialist	4	IV – 1
Specialist për informacionin	1	IV – 2

VIII/II. Sektori i Shërbimeve dhe Financës

Shef sektori	1	III – 1
Specialist	1	IV – 1
Specialist	2	IV – 2
Magaznier/shofer	1	Kl. V*
Shofer	1	Kl. III*
Punonjës pastrimi	1	Kl. I*

(*VKM nr. 326, datë 31.05.2023, i ndryshuar)

Gjithsej **65** punonjës

ANEKSI 2 - MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NGA REZOLUTA E KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2025


REKOMANDIMI	STATUSI	NIVELI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMIT

**ANEKS 3 – REKOMANDIMET E ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR VITIN 2025 PËR INSTITUCIONET PUBLIKE
DHE NIVELI I ZBATIMIT TË TYRE**

Nr.	REKOMANDIMI	KONTROLLUESI/AUTORITETI PUBLIK	AFATI PËR ZBATIM	STATUSI I ZBATIMIT
1.				

ANEKSI 4 - TITULL

Tekst



Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5, Tiranë
Tel: +355 42237200 | www.idp.al